

Mekanizmi kombëtar për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz



Sektori për përparim të
barazisë midis gjinive

Mekanizmi kombëtar për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz



Sektori për përparim të
barazisë midis gjinive

Sektori për përparim të barazisë midis gjinive

Me vendim të Qeverisë së RM në janar të vitit 1997, u formua Sektori për përparim të barazisë midis gjinive (SPBGJ) në kuadër të Ministrisë për punë dhe politikë sociale.

Funksioni themelor i (SPBGJ) është të ndikojë pozitivisht në përparimin e pozitës të gruas dhe ta promovojë barazinë midis gjinive në perputhje me konventat ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar, duke i siguruar grave gëzim të plotë të të drejtave të njeriut. Funksinin e rëndësishëm (SPBGJ) e zbaton përmes inicimit të aktiviteteve konkrete të planit Kombëtar për aksionin për barazi të gjinive të miratuar nga Qeveria e RM në vitin 1999, me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe prioritetëve të dhëna në të njëjtin.

Po ashtu, SPBGJ i koordinon aktivitetet nga fusha e barazisë gjinore në nivel të institucioneve qeveritare, përmes shqyrtimit të ligjeve, akteve nënligjore dhe zgjidhjeve të cilat i propozon Qeveria e RM me dhënien e propozimeve të veta dhe iniciativave për tejkalimin e problemeve me të cilat ballafaqohen gratë në RM. SPBGJ njëkohësisht bashkëpunon dhe e përkrah numrin e madh të aktiviteteve të inicuar nga ana e organizatave joqeveritare.

Me miratimin e ligjit për mundësi të njëjta të grave dhe meshkujve njëra nga detyrat themelore të SPBGJ është implementimi i ligjit si dhe ndjekja dhe mbikqyrja për zbatimin e këtij ligji.

Informacione për kontakt

Sektori për përparim të barazisë midis gjinive

Zyra e mekanizmit Kombëtar për udhezim

Dame Gruev nr.14

1000 Skopje

Tel/Faks: 02/3129308;

Tel: 02/3120 569; 02/3106-469

e-mail: nmuofficemk@yahoo.com

I përgatitur nga ekipi projektus:

Elena Grozdanovska - udhëheqës i SPBGJ

Svetlana Cvetkovska - koordinatore e zyrës së MKU

Igor Vasevski - koordinator në teren

Lençe Kocevski - këshilltare juridike


Perkthim: Edmond Sotir për Tetragon

Dizenj, renditje: Paul R. Adams për Tetragon

Parapergatitje e shtypjes: Tetragon

PËRMJATJE

	Hyrje	7
.....01	Përpjekjet e Ministrisë për punës dhe politikë sociale në luftën kundër tregëtisë me njerëz.....	8
.....02	Përkrahje dhe bashkëpunim me OSKE.....	9
.....03	Bashkëpunim midis MPB dhe MKU në fushën e luftës kundër tregëtisë me njerëz/ femijë.....	10
.....04	Bashkëpunim me derë të Hapur	10
.....05	TBashkëpunim me IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrim).....	10
.....06	Raport për MKU 2005 - 2006.....	11
.....07	Analizë e kapaciteteve të punëtorëve social të nominuar.....	14
.....08	Raport për regullativën ligjore ekzistuese.....	23
.....09	Analizë në bazë të të dhënave për viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz.....	38
.....10	Pjese nga raporti për evaluim (periudha shtator 2005 - korrik 2006).....	44
.....11	Memorandumi për bashkëpunim.....	48
.....12	Foto galeri.....	49





Në raportin e vet për tregëti me njerëz për vitin 2005. Stejt Department informoi se 600.000 deri në 800.000 mijë njerëz në nivel ndërkombëtar janë të tregëtuar, 80% prej tyre janë gra, vajza viktimë në menyra më të ndryshme dhe në veçanti për shfrytëzim seksual, punë e ushtruar me dhunë dhe tregëti me organe. Sipas organizatës Ndërkombëtare të punës (po ashtu nga raporti i vitit 2005) rreth 40% nga numri i përgjithshëm i viktimave janë fëmijë, 98% i viktimave të shfrytëzuar seksualisht janë gra dhe vajza.

Intensiteti i këtij fenomeni në Evropë është në lidhje të ngushtë me gjendjen politike dhe ekonomike, që krijon varfëri dhe e përshpejton emigracionin, të cilin shpeshherë e përbëjnë gra.

Svida për Evropën është e dyfishtë. Politika e Evropës nga njëra anë, është e detyruar të përkrahë dhe të marrë pjesë në zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen sociale të vendeve nga regjioni qendror dhe lindor të cilat shpesh here janë vendet nga të cilat e kanë prejardhjen viktimat e tregëtisë me njerëz. Nga ana tjetër shtetet e Evropës në destinacion duhet të zhvillojnë mekanizma për përkrahje sistematike dhe ndihmë të viktimave në bashkëpunim me partnerët socialë dhe organizatat joqeveritare.

Shteti ynë përmes Komiteti kombëtar të formuar posaçërisht për luftën kundër tregëtisë me njerëz dhe emigrim ilegal, ka përpunuar Strategji dhe plan Kombëtar për luftën kundër tregëtisë me njerëz dhe emigrim ilegal. Plani tashmë ka arritur rezultate të rëndësishme pozitive.


Pjesëmarrja e Ministrisë për punë dhe politikë sociale në keto aktivitete është e forte dhe në kontinuitet, duke pasur parasysh se problemi me dhunën mbi gruan dhe fëmijët është një nga prioritetet politike.

Fenomeni i robërisë moderne është kompleks, ai duhet të jetë i shqyrtuar dhe i preventuar në kuadër të përpjekjeve në luftën kundër krimit të organizuar, preventim dhe denim të shkeljeve të të drejtave të njëriut.

Të prevenohet dhe eliminohet ky fenomen, aksioni vetëm nga ana e shtetit nuk është i mjaftueshëm dhe adekuat. Ajo që është e nevojshme është bashkëpunim midis institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe sektorit joqeveritar. Shteti duhet të bashkëpunojë dhe intenzivisht të mbështetë përpjekjet e organizatave joqeveritare edhe më tej, me qëllim të prevenohet dhe eliminohet ky fenomen.

Lufta kundër dhunës dikton drejtim të intervenimeve jo vetëm drejt ripërtëritjes të strukturës shoqërore por edhe drejt përforsimit të respektimit të të drejtave themelore të njëriut dhe veçanërisht të të drejtave të grave. Në të njëjtën kohë, lufta kundër tregëtisë me njerëz kërkon mobilizimin e secilit prej nesh, sepse problemi po zgjerohet direkt në shoqëri duke i rënuar institucionet.

Problemi na shqetëson të gjithëve.


 Ministër
 Ljupcho Meshkov




Përpjekjet e Ministrisë për punës dhe politikë sociale
në luftën kundër tregëtisë me njerëz

Përkrahje dhe bashkëpunim me OSBE

Përpyjekjet e Ministrisë për punë dhe politikë sociale në luftën kundër tregëtisë me njerëz

Në përputhje me interesat dhe përpyjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për veprim të përbashkët në eliminimin e tregëtisë me njerëz dhe implementimin e programit Kombëtar për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe emigrim ilegal, Ministria për punë dhe politikë sociale i përshpejtoi, rindërtoi dhe i zgjeroi masat dhe aktivitetet për preventim dhe mbrojtje të viktimave të tregëtisë me njerëz dhe në veçanti me gra dhe fëmijë.

Në këtë kontekst, në Ministrinë për punë dhe politikë sociale nga shtatori i vitit 2005 suksesshëm funksionon zyra e mekanizmit Kombëtar për udhëzim e formuar në kuadër të projektit të cilin e realizoi Ministria për punë dhe politikë sociale dhe komisioni Kombëtar për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe emigrim ilegal në bashkëpunim me misionin e OSKE në Republikën e Maqedonisë. Në këtë projekt janë inkuadruar Qendrat për punë sociale, institucionet vendore, organizatat Joqeveritare, Lidhja e organizatave të punëtorëve socialë dhe Komisionet për barazi gjinore nga njësitë e vetqeverisjes vendore.

Zyra për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz promovon një praktikë të mirë të ndërtimit demokratik të institucioneve, përmes përparimit dhe koordinimit të lidhjeve efektive midis institucioneve shtetërore dhe shoqërisë qytetare, por po ashtu e informojmë publikun dhe organet shtetërore se është i nevojshëm ndryshim i perceptonit për tregëtinë me njerëz me qëllim që të kuptohet se tregëtia me njerëz është shkelje flagrante e të drejtave të njëriut të viktimës. Mbartës të pa ndërmjetshëm të të gjitha aktiviteteve në fushën e mbrojtjes sociale për preventim dhe ulje të tregëtisë me njerëz në nivel vendor janë Qendrat për punë sociale.

Duke i patur parasysh se Qendrat për punë sociale janë institucione funksionale të cilat ushtrojnë shumë detyra në realizimin e aktiviteteve preventive për mrojtjen sociale, cdo ditë takohen me kategori të ndryshme të qytetarëve në veçanti me gra dhe fëmijë të cilët mund të jenë viktimë potenciale të tregëtisë me njerëz.

Duke i realizuar aktivitetet e veta përmes punës interdisciplinare të ekipit në të cilën janë inkuadruar edhe punëtorët social të cilët paraqesin kuadrin mbartës në Qendrat për punë sociale në periudhën e mëtejshme punën e vetë do të duhet ta drejtojnë në aktivitete për preventim dhe mrojtje të viktimave të tregëtisë me njerëz në veçanti fëmijë.

Qëndrat për punë sociale punën e vetë do ta realizojnë përmes: zbulimit ose njohjes të viktimave të tregëtisë me njerëz, duke u ofruar ndihmë dhe mbrojtje, duke ndërtuar rrjet bashkëpunimi në nivel vendor, rritjen e vetëdijes publike në kuptim të

aktiviteteve preventive por në ndihmë të pandërmjetshme të viktimave tashmë bashkëpunuesorë me Zyrën e mekanizmit kombëtar në Ministrinë për punë dhe politikë sociale. Me qëllim realizim të suksesshëm të këtyre aktiviteteve dhe qasje të njëjtë në punën profesionale të të gjithë qendrave për punë sociale, Ministria për punë dhe politikë sociale do të nënshkruajë një numër të caktuar dokumentash profesionale për të cilat do të jenë të angazhuar institucione dhe ekspertë relevantë.

Duke patur parasysh faktin se për rielizim të suksesshëm të këtyre aktiviteteve janë të nevojshme edhe ambiente përshtatëse dhe kritere teknike për punë me viktimat e tregëtisë me njerëz në veçanti me fëmijë Ministria për punë dhe politikë sociale në bashkëpunim me misionin e OSKE në Republikën e Maqedonisë dhe zyrën e UNICEF siguroi mjete zyrtare dhe paisje teknike për 15 Qendra për punë sociale por edhe për zyrën e Lidhjes të organizatave të punëtorëve socialë të Republikës së Maqedonisë ku do të funksionojë Zyra e mekanizmit Kombëtar për udhëzim.

Me qëllim përforsim të vazhdueshëm të profileve profesionale në Qendrat kompetente për punë sociale me përkrahje të organizatës Ndërkombëtare për emigrim-IOM kanë qënë organizuar gjashtë seminare dhe janë edukuar plotësisht 120 punëtorë socialë dhe antarë të komisioneve për barazi gjinore në disa njësi të vetëqeverisjes vendore. Po ashtu janë realizuar 4 seminare për trajtim të psikologëve, pedagogëve dhe juristëve në të cilat kanë qënë të inkuadruara edhe organizata joqeveritare. Në periudhën e kaluar Ministria për punë dhe politikë sociale në bashkëpunim me zyrën e UNICEF organizoi tranjim special për punëtorët socialë të nominuar nga 27 Qendra për punë sociale dhe inspektorë për luftë kundër tregëtisë me fëmijë në Ministrinë e punëve të brendshme, që do të thotë se ministria në kontinuitet vazhdon të realizojë aktivitete të këtij karakteri dhe kjo me qëllim zvogëlimin e këtij lloji krimi në shtetin tonë. Në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF, ministria përpunoi edhe Programin për risocializim dhe reintegrim të fëmijëve viktimë të tregëtisë me njerëz në lidhje me të cilën është realizimi i trajtimeve me ekipet profesionale të Qendrave për punë sociale.

Ministria për punë dhe politikë sociale dhe zyra e koordinimit të mekanizmit Kombëtar për udhëzim do ta përkrahë edhe më tej formimin e kornizës për bashkëpunim të të gjitha institucioneve kompetente shtetërore, me këtë Republika e Maqedonisë do të mund ti plotësojë obligimet e veta për mbrojtje dhe përparim të të drejtave të njëriut të viktimave të tregëtisë me njerëz, në koordinim dhe partneritet strategjik me shoqërinë qytetare dhe pjesmarësit e tjerë të cilët punojnë në këtë fushë.

Elena Grozdanova
Udhëheqëse e OUPR

Përkrahje dhe bashkëpunim me OSBE

Në terminologjinë e OSBE-së, Mekanizmi Nacional për Udhëzim (MNU) paraqet kornizë për bashkëpunim nëpërmjet të cilës institucionet shtetërore i përbushin obligimet e tyre për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave njerëzore të viktimave të trafikimit me njerëz, duke i kordinuar përpjekjet e tyre në partneritet strategjik me shoqërinë civile. Veç kësaj, MNU punon në përmirësimin e politikës kombëtare dhe procedurave që kanë të bëjnë me çështje të një diapazoni më të gjerë në lidhje me viktimat, siç janë normat për banim dhe riatdhesim, dëmshpërblim për viktimat, dhe mbrojtje e dëshmitarëve. Me rëndësi është se, MNU mund të vendos etapa vlerësuese nëse qëllimet Shtetërore kundër tregëtisë me qenie njerëzore janë arritur.

Struktura e MNU-së ndryshon në çdo shtet. Implementimi i politikës të bazuar në të drejtat e përgjithshme kundër tregëtisë me qenie njerëzore duhet të vështrohet si një element i qeverisjes demokratike dhe transparente e bazuar në sundimin e ligjit. Kështuqë, parakusht vendimtar për masat efektive kundër tregëtisë me njerëz është ngritja dhe forcimi i institucioneve përkatëse vendore dhe kombëtare. Gjithashtu, funksionimi i mekanizmit është subjekt i vlerësimeve periodike me qëllim të identifikimit të mungesave duke e adaptuar atë me nevojat dhe kushtet që do të paraqiten. Në nivel lokal, MNU është dizajnuar në bazë të rethanave vendore dhe është përpiluar për të përbushur nevojat e shtetit.

Në thelbin e çdo MNU është procesi i gjetjes dhe identifikimit të mundshëm të viktimave të tregëtisë me qenie njerëzore, të cilat zakonisht janë të njohura si "persona që supozohet të jenë të trafikuar". Ky proces përfshin të gjithë organizatat e ndryshme të involvuara në MNU, i cili duhet të bashkëpunojë për të siguruar se viktimave të tilla të supozuara u është ofruar ndihmë nëpërmjet të udhëzimit të tyre tek shërbimet e specializuara. Ministria e punës dhe politikës sociale e pranoi rolin e saj dhe përgjegjësinë në këtë fushë dhe ndërmori hapin e parë në mobilizimin mbarë-kombëtar si reagim kundër tregëtisë me qenie njerëzore. Dhe po ky hap nuk ishte një hap i lehtë për tu ndërmarrë. Implementimi i projektit të MNU-së filloi në shtator 2005 me vlerësim fillestar dhe konsultime të një rethi më të gjërë me aktorët përkatës. Disa muaj më pas Zyra Koordinuese e MNU-së ishte e formuar nën kornizën e Ministrisë dhe Zyres për avancimin e barazisë gjinore. Mandej gjërat vërtet filluan të shkojnë para. Pas përfundimit të detyrave fillestare koordinuese dhe sigurimit të përkrahjes nga aktorët kryesor, zyra koordinuese e MNU-së ndërmori udhëzimet e para të saja. Sot, me krenari mund të themi se duke ju falënderuar personelit të zyres së MNU-së, koncepti dhe ky projekt janë mjaft të njohur dhe të çmuar kudo në shtet, në Qendrat për punë sociale, OJQ-të partnere dhe personat kryesor në Ministrinë tjera.

Deri tani dy pikësnyime madhore janë arritur. Domethënë, procesi i cili dërgon drejt identifikimit të viktimave është treguar se funksionon, duke ju faleminderuar poashtu efikasitetit të shkëlqyeshëm të punëtorëve social të shpërndarë nëpër gjithë

vendin. Ndonëse shumica e punëtorëve social ishin të posaçdhur në arenën e tregëtisë me qenie njerëzore, treguan angazhim dhe profesionalizëm. Në veçanti, rezultatet e këtilla pozitive kanë kontribuar poashtu për ta vlerësuar më saktësisht horizontin e këtij fenomeni. Gjithashtu ka identifikuar tendencat dhe modelet, veç kësaj ka kontribuar në mbledhjen e të dhënave të besueshme dhe përpunimin e tyre.

Pikësnyimi i dytë madhor, përmirësimi i koordinimit të ndihmës në dispozicion, ka bërë një avancim të qëndrueshëm. Institucionet që ofrojnë ndihmë tani janë më mirë të koordinuar duke iu faleminderuar drejtimeve të dhëna nga turpi qëndror koordinues, zyres së MNU-së, duke e mënjanuar duplikimin e orvatjeve.

Bashkëpunimi në mes aktorëve Qeveritar dhe jo-qeveritar poashtu është në ritje të dukshme dhe është e rregulluar me ad hoc memorandume për mirëkuptim. Zgjidhjet e tilla i reflektojnë praktikën e mira Europiane dhe në të njëjtën kohë harmonizojnë mekanizmat vendor me standardet Europiane dhe Ndërkombëtare. Roli kryesor i shoqërisë civile bëhet më i dukshëm në fushat lidhur me parandalimin dhe ndihmën ku shoqëria civile luan një rol crucial duke i plotësuar funksionet e trupave Qeveritare.

Avancimi i stabilizuar i arritur deri tani mundet më tej të përmirësohet duke i adresuar mungesat në fushën e zbatimit të ligjit, mbrojtje dhe procedurat operative. Zbatuesit e ligjit duhet ta përmirësojnë bashkëpunimin me trupat tjerë të MNU-së të involvuar në fazën e identifikimit. Pa këtë përmirësim, do të vazhdojë përcjellja e pa mjaftueshme në fushën e hetimit, ndjekjes penale dhe dëmshpërblimit. Lidhur me procedurat operative, paraqitet nevoja për orvatje më të mëdha në arritjen e një konsensusi në mes të gjithë palëve, për të promovuar pronësinë ndaj këtyre procedurave.

Shpreh mirënjohjen time të posaçme deri tek Ministria për punë dhe politikë sociale për themelimin e shpejtë të zyres së MNU-së, sikurse edhe demonstrimin e angazhimit dhe entuzijazmit për organizimin e këtij mekanizmi. Poashtu do kisha dashur ti faleminderohem UNICEF-it dhe IOM për kontributin dhe përkrahjen e dhënë drejt iniciativave për trajnime.

Gjithë këto orvatje kanë për qëllim ti mbrojnë viktimat dhe t'ju sigurojnë ndihmën e nevojshme për mirëqenien e tyre dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Monika Portillo

*Oficer i Lartë për Sundimin e së drejtës
Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup*



**Bashkëpunim midis MPB dhe MKU në fushën e luftës kundër
tregëtisë me njerëz/ femijë**

**Bashkëpunim me IOM
(Organizata Ndërkombëtare për Migrim)**

Raport për MKU 2005 - 2006

Bashkëpunimi ndërmjet MPB-së dhe MKU në fushën e luftës kundër tregëtisë me njerëz/fëmijë

Duke u nisur nga fakti se tregtia me njerëz paraqet shkelje serioze të të drejtave fundamentale njerëzore të cilat shtetet kanë për obligim t'i ndalojnë, MPB në pjesën e kompetencave të saja në kuadër të Seksionit për krim të organizuar ka formuar Seksion të veçantë me qëllim që në mënyrë të organizuar t'i rezistojë të gjitha format e tregëtisë me njerëz në vend dhe vënie të bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar me institucione, agjenci dhe shërbime të autorizuar nga ministritë tjera të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, si dhe OJQ ndërkombëtare dhe të vendit. Ministria e Punëve të Brendshme - Seksioni për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe krim tjetër të dhunshëm dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - Mekanizmi Kombëtar për Udhëzime (MKU), në periudhën e kaluar kanë zhvilluar model të vetëm të bashkëpunimit institucional dhe komunikim ndërmjet institucioneve dhe ushtruesve.

Seksioni për luftë kundër tregëtisë me njerëz në mënyrë aktive bashkëpunon me institucionet e sistemit, përfshirë edhe MKU, në më tepër nivele: parandalim, intervenim, mbrojtje dhe edukim, ndërsa çelësi i bashkëpunimit të mirë shtrihet në respektimin e kompetencave dhe qasjes së veprimit ekipor me ndërtim profesional të kapaciteteve dhe krijimit të rrjetit të bashkëpunësorëve profesionistë.

Në këtë drejtim për theksim janë edukimet e zbatuara në organizim të MKU të përkrahura nga OSBE dhe UNICEF për punëtorët e detashuar socialë të obliguar për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe fëmijë të cilët ishin grupi qëllimor i ciklit të trajnimeve - seminareve për tregti me njerëz, me qëllim të veprimit profesional, udhëheqjes adekuate të intervistës dhe njohjes së ndërsjellë për ndërmarrjen e aktiviteteve të koordinuara në rajonet nga vijnë.

Thellimi, përparimi i bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta për realizim në periudhën e ardhshme ndërmjet MPB-së dhe MKU-së do të zhvillohen

në drejtim të identifikimit të drejtë dhe të shpejtë të viktimit të tregëtisë, ofrimit të përkrahjes, kthimit dhe riintegrit të viktimit, veçanërisht fëmijët viktima, vazhdim të trajnimeve dhe seminareve për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, vënie të sistemit të vetëm informativ, ndikim informativ-propagandistik në mendimin publik, si dhe zyrtarizim të komunikimit të ndërsjellë.

Është për tu theksuar në mënyrë të veçantë bashkëpunimi i mirë i MKU-së dhe Nëngrupit për luftë kundër tregëtisë me fëmijë në planin e luftës kundër krimit të organizuar, me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë nga tregtia dhe eksploatiimi, si dhe dhënie të përparësisë absolute të të drejtave dhe interesave të fëmijëve në pajtim me Planin aksionar për ndalim të tregëtisë me fëmijë, implementimi i së cilës është në rrjedhë.

Sanija Burageva
Inspektor kryesor në
Seksionin për luftë kundër tregëtisë
me njerëz dhe Kryesues i nëngrupit për luftë kundër
tregëtisë me fëmijë

Punëtorët social - Bashkëpunimi IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrim)/MPPS

Bashkëpunimi i shkëlqyer i vendosur paraprakisht midis Organizatës Ndërkombëtare për Migrim dhe Ministrisë së punës dhe politikë sociale ishte përparuar përmes dimensionit operacional me implementimin e "Kundër tregëtisë: Preventim dhe aktivitete për përforsim të kapaciteteve në Kosovë dhe Maqedoni" projekt i cili është mbështetur nga ana e Qeverisë së Finlandës. Me këtë projekt IOM Skopje dhe Ministria e punës dhe politikë sociale (MPPS) në vecanti me Sektorin për përparim të barazisë midis gjinive dhe Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Udhëzim bashkëpunonin në shumë aktivitete si më poshtë:

- Zbatim të trajnimeve në seanca për punëtorët social dhe antarëve të Komisioneve për barazi

gjinore në komunitetet vendore në Maqedoni - në periudhën Qershor 2006. Me pesë trajnimet janë trajnuar 116 punëtorë social nga 27 Qendra për punë sociale nga tërë vendi po ashtu janë trajnuar dhjetë komisione vendore për barazi gjinore.

- Zbatim të trajnimeve për profesionalistë të cilët punojnë në Qendrat për punë sociale nëpër vend dhe partnerë vendorë OJQ- 96 profesionalistë nga QPS dhe OQJ-të vendore fituan trajnime për tregëtimin me njerëz dhe intervime me viktima të tregëtisë.

- Zbatim të mikro-proekteve themeltare për preventim - gjithsej janë zbatuar 5 mikro proekte: Dy (2) në QPS Kocan, Dy (2) në QPS Bitolë, dhe një nga Sektori për përparim të barazisë gjinore dhe zyra e Mekanizmit Kombëtar për udhëzim (të drejtuar drejt grupeve të plagshme dhe punë për ngritjen e vetëdijes dhe preventim në luftën kundër tregëtisë me njerëz dhe përcaktim të profesionalistëve nga profile të ndryshme të cilët punojnë në nivel vendor mund të ndihmojnë për preventimin në tregëtimin me njerëz në komunitetin vendor).

- Marja pjesë aktivishtë në asistimin Direkt dhe udhëzim në shërbimet e grupit punës.

- Marja pjesë në Mbledhjet e Bordi Drejtues inkuadrim në procesin e marjes së vendimeve përmes zbatimit të tërësishëm të projektit.

Inkuadrim të MPPS/ SPBGJ në aktivitetet kombëtare kundër tregëtisë me rëndësi kryesore vecanërisht në fushën e preventimit të tregëtisë me njerëz, identifikim të parakohshëm të procesit të tregëtisë me njerëz dhe udhëzimin e drejtë të viktimit të tregëtisë me njerëz dhe ndihmë efektive dhe riintegrim të viktimës të tregëtuar. Ministria e punës dhe politikë sociale po ashtu merrte pjesë direkte në asistencën e viktimit të huaj (numër jo i rëndësishëm) përmes dhënies të mbrojtjes sociale të matur (në formë të kujdestarit) të viktimit të mitur të tregëtisë.

IOM Shkup dhe zyra e Mekanizmit Kombëtar për Udhëzim inicuan rrugë të koordinuar për asistencë direkte në procesin për risocializim të viktimit të tregëtisë nga vendi. IOM beson fortë se përmes rritjes së kapaciteteve vendore dhe qendrore të Ministrisë së

Punës dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë do ta zhvillojë angazhimin dhe efektivitetin e aktorëve të inkuadruar në luftën kundër tregëtisë me njerëz.

Parapëlqimet e OJQ "Porta e hapur" - La Strada Maqedoni drejtuar Mekanizmit Kombëtar për Udhëzime në MPPS

OJQ "Porta e hapur" - La Strada Maqedoni është organizatë e cila në mënyrë aktive punon në fushën e luftës kundër tregëtisë me njerëz përmes programeve vijuese: informim dhe lobim, parandalim dhe edukim, dhe përkrahje e drejtpërdrejtë e viktimave të tregëtisë me njerëz.

Në kuadër të programit për ofrimin e përkrahjes së drejtpërdrejtë të viktimave të tregëtisë me njerëz, nga korriku i vitit 2005 ka filluar me punë projekti Rezidenca - Strehimore për përkujdesjen e viktimave të tregëtisë me njerëz.

Në periudhën e kaluar janë strehuar gjithsej 13 klientë sipas kategorive vijuese: të supozuar, potencialë dhe viktimat të tregëtisë me njerëz. Mënyra e udhëzimit të viktimave është si vijon: Mekanizmi Kombëtar për Udhëzime, MPB, SOS linja për ndihmë të viktimave të tregëtisë me njerëz si dhe organizatat joqeveritare lokale dhe rajonale.

Me rëndësi të veçantë për mënyrën e udhëzimit të viktimave të tregëtisë me njerëz është Mekanizmi Kombëtar për Udhëzime në MPPS. Më 14 korrik 2006 OJQ "Porta e hapur" dhe MPPS/MKU nënshkruan memorandum për bashkëpunim ku u vërtetuan procedurat dhe mënyrat e bashkëpunimit me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të viktimave të tregëtisë me njerëz. Me hapjen e zyres së Mekanizmit Kombëtar për Udhëzime në strehimore janë dërguar 4 raste të viktimave të tregëtisë me njerëz.

Kjo e dhënë tregon faktin se ekzistimi i MKU është i nevojshëm gjatë procesit të njohjes, udhëzimit, si dhe gjatë procesit të riintegritimit të viktimave të tregëtisë me njerëz.

Njëkohësisht përmes mekanizmit kombëtar për

udhëzim janë përmirësuar kontaktet me qendrat për punë sociale të cilat janë të rëndësishme gjatë procesit të riintegritimit dhe risocializimit të klientëve të vendosur në strehimore.

Duke i falënderuar mekanizmit kombëtar për udhëzime viktimat e tregëtisë me njerëz janë të informuar për ekzistimin e strehimores dhe shërbimeve të cilat ua ofrojmë klientëve.

Shpresojmë se bashkëpunimi i suksesshëm i deritashëm do të vazhdojë edhe më tej.

OJQ "Porta e hapur" - La Strada Maqedoni

Mekanizmi Kombëtar për udhëzim Raport për dhjetor 2005 - dhjetor 2006

Ministria për punë dhe politikë sociale nga shtatori i vitit 2005 ka realizuar Projektin mekanizmi Kombëtar për udhëzim (MKU) me përkrahjen e misionit të OSKE në Shkup.

Projekti mundëson mekanizëm Kombëtar për udhëzim (MKU) të institucionalizuar dhe operacionalizuar, me qëllim ta forcojë kapacitetin e shtetit për sigurim të identifikimit adekuat, ndihmë dhe mrojtje, të bazuara në të drejtat ndërkombëtare të njëriut, të të gjitha viktimave të tregëtisë me njerëz, në veçanti me të mitur, pa dallim të kombësisë, prejardhjes etnike, moshës apo gjinisë.

Në zyrën Koordinative të MKU në këtë projekt është angazhuar dhe punon ekip prej katër anëtarësh: këshilltar, koordinator i projektit, koordinator për teren dhe përfaqësues juridik.

Aktivitete të realizuara Edukime

Qendrat për punë sociale (QPS) janë disa prej aktorëve kryesorë në identifikimin dhe udhëz-

imin e viktimave deri në qasjen e ndihmës. Për ndërtim sistematik të kapaciteteve të punëtorëve social është mbajtur një seri prej 14 seminarëve të përkrahura nga OSKE, UNICEF dhe IOM në të cilat ishin inkuadruar edhe inspektorë nga MPB për luftë kundër tregëtisë me njerëz, ekipet profesionale nga QPS (psiholog, pedagog, jurist) komisionet për barazi të njejtë gjinore nga njësitë vendore dhe OJQ.

58 punëtorët social të nominuar kaluan 3 tranjime (një tranjim themelor për luftë kundër tregëtisë me njerëz, dhe dy tranjime të specializuara për punë me viktimat e tregëtisë me njerëz dhe punë me fëmijë viktimat të tregëtisë). Në tranjimin për punë me fëmijë viktimat të tregëtisë ishin inkuadruar 20 inspektorë nga MPB, për luftë kundër tregëtisë me njerëz, inspektorë të cilët punojnë me prolemin e delikuencisë së mitur dhe me dhunën familjare.

Përplotësisht për tipin themelor të tranjimit janë të tranjuar edhe 116 punëtor social, 96 persona prej ekipeve profesionale, 20 persona nga Komisionet për mundësi të njejtat të grave dhe burave në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 30 përfaqësues të OJQ-së nga qytete të ndryshme.

Mobilim i zyrave

Donacioni i paisjeve kompjuterike dhe paisjeve të zyrave të siguruara nga OSKE, inicoi pëparim pozitiv në përkrahjen logjistike të QPS në vend, si dhe kushte solide për punë të punëtorëve social. Donacioni iniciator i tetë QPS nga ana e OSKE, si dhe ndikimi pozitiv në punën e qendrave, ndikonte në përkrahjen që UNICEF plotësisht të mobilojë edhe shtatë qendra duke i adaptuar 15 QPS në ambiente komode fëmijësh. Këto zyra funksionojnë në QPS në: Tetovë, Kërçovë, Dibër, Ohër, Manastir, Prilep, Veles, Koçani, Strumicë, Delçevë, Kumanovë, Kriva Palankë, Strugë, Gjevgjeli dhe Shtip.

Këto zyra shërbejnë për punën me viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz, punë me persona të mitur dhe të njejtat mund ti shfrytëzojnë edhe inspektorët për luftë kundër tregëtisë me njerëz si dhe gjykatësit hetimorë.

Vizitat studiuese

Gjatë vitit 2006 Zyra e MKU organizoi dhe implementoi dy vizita studiuese në Shqipëri dhe Bullgari (në vitin 2005 vizitë studiuese në Serbi të 10 personave), vizita studiuese në Shqipëri, e ndihmuar nga ana e "Teress des Hommes" dhe partnerët nga Shqipëria, u realizua prej 7 deri në 10 maj 2006. Në të morën pjesë 10 anëtarë të delegacionit kombëtar të përbërë prej punëtorëve social, drejtorët e Qendrave për punë sociale dhe personeli i Zyrës së MKU. Zyra e MKU, prej 11 deri në 13 qershor 2006, organizoi dhe realizoi vizita studiuese në Sofije, Bullgari, për pesë persona, e ndihmuar nga GTF e Paktit për stabilitet në Bullgari. Vizita studiuese kishte për qëllim shkëmbim të përvojave dhe "mësim të lëksionit", nga ana e punëtorëve social të cilët janë pjesë e MKU dhe institucioneve, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ të cilat punojnë në fushën e preventimit dhe mbrojtjes të viktimave të tregëtisë me njerëz në vendet fqinje.

Udhëzim

Zyra e MKU ishte e inkuadruar në disa raste për udhëzim, të cilët kanë lidhje me persona për të cilët paragjykohet se janë viktimë të tregëtisë me njerëz dhe me viktimat e identifikuar. Në aktivitetet e ndërmara të Zyrës të MKU përfshihen aktivitetet të ndryshme nga ana e personelit, duke filluar me menaxhimin e informacioneve, përmes udhëzimit të viktimave deri tek siguruesit direkt të ndihmës, strehim, duke përfunduar me ndjekjen e çështjeve gjyqësore.

Po ashtu janë realizuar disa vizita për ndjekje të punës të Strehimit të udhëhequra nga OJQ "Dera e Hapur" me qëllim që të bëhen bisedime me viktimat e udhëzuara dhe po ashtu, të bisedohet për të gjitha çështjet, të vlerësohet situata dhe gjendja e viktimave dhe të vlerësohen nevojat e tyre.

Baza e të dhënave

Zyra e MKU udhëheq bazën e të dhënave elektronike dhe të shtypura e cila përmban informacione për të gjitha aktivitetet për çështje individuale. Gjatë 2006, në zyrën e MKU nga Qendrat për punë sociale janë dorëzuar të dhëna për 23 çështje të viktimave të identifikuar dhe viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz. Katër prej tyre kanë qenë të udhëzuara në strehimin e Derës së hapur, të tjerat janë kthyer në familjet e veta. Në dy QPS po koordinohet për vendosje të kujdestarit të përkohshëm për 4 persona të mitur shtetas të huaj të strehuar në qendrën Tranzicionale, dhe përmes ministrive kompetente po koordinohet caktimi i mundësive për kthimin e fëmijëve në shtetet e tyre.

Për 4 shtetas të Maqedonisë po koordinohet procedurë për vlerësimin e familjeve dhe caktimin e mundësive për kthimin e tyre the pranimin në Maqedoni.

Zyra koordinative krijoi disa dokumente si bazë e të dhënave të cilat përmbajnë informacione për organizatat të cilat mundësojnë shërbime për viktimat nga tregëtija, si dhe informacione për serviset të cilët janë të mundësuar nga vetë zyra e MKU. Për atë qëllim, të gjitha QPS në vend janë kontaktuar me qëllim që ato të sigurojnë dhe rregullisht të dorëzojnë raporte për ndihmën që u është dhënë viktimave. Në shtesë, është zhvilluar pyetësor i standartizuar për evidencën dhe për punën në çështje të veçanta, por edhe për analizën e të dhënave dhe shkëmbimin e informacioneve me qëllim që të sigurohen fakte më të sigurta për proceset e ardhshme. Këto të dhëna përherë plotësohen në bazën për të dhëna në MKU.

Arritja pozitive është se nga ana e Entit për veprimtari sociale, janë përpunuar të ashtuquajturat instrumente për institucione sociale në listat për evidencë për QPS ku si kategori e re e shfrytëzuesve është instaluar - viktimat të tregëtisë me njerëz. Zyra e MKU, po ashtu punon bashkë me Entin për veprimtari sociale në përgatitjen e Pyetësorit për viktimat të tregëtisë me njerëz, si pjesë e listës të evidencës me qëllim të mbledhjen të dhëna të unifikuara të cilat do të përpunohen në të ardhmen.

Si komponent i veçantë në data bazën është edhe baza e të dhënave për të gjithë individët të cilët patën trajtim për pyetjet në lidhje me tregëtinë me njerëz.

Komponent i tretë në data bazën janë të dhënat të fituara nga humultimi për kapacitetet e punëtorëve social të nominuar në MKU. Të dhënat janë strukturuar në 3 pjesë të komplementuara dhe u përkasin: karakteristikave social-profesionale të punëtorëve socialë të nominuar, kapaciteteve administrative dhe kushteve në të cilët punojnë punëtorët socialë dhe vetëidentifikimit me MKU.

Analizë juridike

Është përgatitur analizë juridike e rregullativës ligjore e cila është relevante për MKU. Qëllimi i kësaj analize është që ta deduktojë dobësinë e sistemit ligjor në relacion të mrojtjes dhe preventimit nga tregëtija me njerëz dhe ngritje të padisë penale kundër shkakëtarëve, si dhe të japë rekomandime të cilat do ta përmirësojnë kujdesin për viktimat dhe situatën në tërësi.

Tryezë e rrumbullakë

Ne dhjetor të vitit 2005 është mbajtur tryeza e rrumbullakët me qëllim tu prezantoje institucioneve relevante konceptin e mekanizmit nacional për udhëzim si dhe projekt aktivitetet që do të realizohen në periudhën e ardhshme. Ne 21 prill 2006 Zyra e MKU mbajti tryezen e dyte të rrumbullakët me temë : Funksionimi i MKU për viktimat e tregëtisë me njerëz - rezultate të arritura dhe sfida . Qëllimi i kësaj tryeze të rrumbullakët ishte të mbledhë përfaqësuesit dhe drejtuesit e të gjithë QPS, punonjësit e tjerë socialë, OJQ dhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, personat zyrtarë, në një vend për të diskutuar për arritjet e MKU në shtet.

Në 12 dhjetor 2006 u mbajt tavolina e tretë e rrumbullakët me temë Roli i Qendrës për punë sociale në parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave nga tregëtia me njerëz. Retorika ishte përqendruar me shqyrtimin e resurseve të cilat janë të disponueshme , problemet me të cilat përballen qendrat dhe këshilla për aktivitetet e ardhshme

Takime pune dhe vizitë të QPS

Me qëllim thellim të bashkëpunimit midis QPS, policia dhe sektori OJQ, njohjen e të pranishmëve me aktivitetet në vijim të zyrës së MKU, si dhe planet për aktivitetet të ardhshme janë bërë katër takime regjionale në Ohër, Bitolë, Prilep, dhe Kërçovë, dhe janë mbajtur tetë takime pune në QPS në Tetovë, Gostivar, Gjevgjeli, Veles, Shën Nikoll, Koçan, Strumicë dhe Kumanovë.

Bashkëpunim

Zyra e MKU krijoi kontakte të forta me shumë institucione qeveritare dhe organizata joqeveritare. Është nënshkruar Memorandum për mirëkuptim me OJQ Dera e Hapur për vendosjen e komunikimit zyrtar dhe sistem për udhëzim dhe fillim të bashkëpunimit të ardhshëm. Në proces është procedura për nënshkrim të Memorandumit për mirëkuptim me MPB.

Zyra e MKU ka bashkëpunim të afërt dhe koordinim me të gjitha koalicionet vendore për luftë kundër tregëtisë dhe komisioneve për mundësi të njëjta të grave dhe burave në njësitë vendore.

Në disa rikthime, Zyra e MKU i prezantoi aktivitetet e veta para Sekretariatit të komisionit kombëtar dhe plotësisht përgatiti raport të shkruar për punën e vetë dhe ja dorëzoi Sekretariatit.

Janë mbajtur edhe takime të rregullta koordinative me organizatat ndërkombëtare

bëtare të cilat kanë programe për luftën kundër tregëtisë me njerëz në RM. Qëllimi i këtyre takimeve koordinative ka qenë shkëmbimi i informacioneve dhe informimi për realizimin e aktiviteteve në kuadër të projektit MKU, si dhe planet e ardhshme dhe drejtimet për punë.

Program për resocializim dhe reintegrim të fëmijëve viktimat të tregëtisë me njerëz

Me mbështetje të UNICEF është përgatitur Projekt Programi për resocializim dhe reintegrim të fëmijëve viktimat të tregëtisë me njerëz. Ky dokument ka qenë i shqyrtuar në debat publik dhe në aspekt të përmbajtjes është vlerësuar si gjithpërfshirës me nevojë për shpjegime plotësuese të vogla për periudhën e zbatimit të ingerencave të Ministrisë së arsimit. Deri në fund të vitit 2006 janë mbajtur 4 tranjime për ekipet profesionale nga QPS për implementim të programit. Në bazë të këtij Programi QPS gjatë punës së saj do të duhet të përgatitise programe individuale për resocializim dhe reintegrim për secilën çështje në veçanti.

Standartizim i veprimeve

Në rrjedhë është përgatitja e Udhëzimit për veprim për mrojtje të viktimave të tregëtisë me njerëz qytetarë të RM. Ky dokument do të përmbajë procedurat standarte të cilat do të ndërmeren nga ana e institucioneve kompetente. Udhëzimi do të dërgohet të gjitha QPS dhe punëtorëve social në MKU.

Pjesëmarrje në seminare dhe konferenca

Me ftesë të Misionit të OSKE në Mal të Zi në Titograd në seminar për përfaqësuesit e ekipeve nga Ministria e Punëve të brendshme, Ministria për punë dhe politikë sociale, Ministria e shëndetësisë dhe Ministria e arsimit është prezantuar projekti i MKU.

Funksionimi i MKU është prezantuar në seminare të organizuara nga OJQ: Semper, SOZHM, Dera e Hapur dhe nga Kryqi i Kuq i RM.

Është realizuar pjesëmarrje në radion Maqedonase në emisionin dëgjoni radio në të cilën po ashtu është promovuar projekti.

Projekti MKU është regjistruar në SEE Liaison Office against Trafficking in Human Beings, e cila është themeluar nga Pakti për stabilitet në Evropën Juglindore në OJQ ARSIS nga Selaniku R. e Greqisë.

The background features a large, faint, light gray logo of the Albanian Social Workers Association (ASB). The logo is a stylized circular emblem. It consists of a central circle, a larger circle around it, and a series of curved, overlapping lines on the right side that resemble a hand or a fan. The text is centered over this logo.

Analizë e kapaciteteve të punëtorëve social të nominuar

Hyrje

Mekanizmi Kombëtar për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz është vendosur mjet proekti në kornizat e Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Sektori për përparim të barazisë midis gjinive. Nën këto kushte kanë qënë të nominuar 58 punëtorë social nga të gjitha qendrat ndërkomunale për punë sociale në teritorin e Republikës së Maqedonisë.

Midis aktiviteteve prioritare të mekanizmit kombëtar për udhëzim ka qënë edhe forcimi i kapacitetit institucional të Qendrave për punë sociale në luftën kundër tregëtisë me njerëz por me parashenjë social-preventive drejt problemit të tregëtisë me njerëz d.m.th. punëtorët social të punësuar në QPS të fitojnë dituri, shkathtësi, përvojë teorike dhe praktike kundrejt problemit të tregëtisë me njerëz.

Për këtë qëllim nga ana e zyrës së MKU është përgatitur dhe distribuar anketë pyetësore tek punëtorët social të nominuar me të cilën ka për qëllim ti analizojë dhe përcaktojë kapacitetet profesionale të punëtorëve socialë të nominuar. Pyetësi anketor është i përbërë prej 20 pyetjesh të karakterit të kombinuar (tip i hapur-mbyllur dhe pyetje të strukturuar-gjysëm të strukturuar).

Përgjithësisht pyetësi anketor është i përbërë prej 3 pjesësh komplementare për objektivizim të kapaciteteve të punëtorëve social të nominuar dhe kjo në mënyrën që vijon :

- A.
Karakteristikat social-profesionale të punëtorëve social të nominuar
- B.
Kapacitete administrative dhe kushtet në të cilat punojnë punëtorët socialë
- C.
Vetidentifikim me MKU

2. Analizë e të dhënave

A. Karakteristikat social-profesionale të punëtorëve socialë të nominuari.

2. A.1


Potenciali njerëzor i mek-anizmit Kombëtar për udhëzimin e viktimave të tregëtisë me njerëz, veçanarisht me gra dhe fëmijë është i rëndësishëm për shkak se duhet plotësisht, në mënyrë konsekuente dhe profesionale të implementojë aktivitetet e parashikuara. Me këtë qëllim kontrolli në kapacitetet njerëzore është një nga parakushtet e rëndësishme për mirëmbajtjen e tij. Nga anketimi i kryer janë përcaktuar gjendjet që vijnë të karakteristikave social-profesionale të punëtorëve social të nominuar.

Shtojcë nr.1

Përfaqësimi gjinor në MKU

Gjinia	Numri absolut	%
Bura	19	34%
Gra	37	66%

Përfaqësimi gjinor në MKU



Përfundime:

Përfaqësimi gjinor në MKU prej punëtorëve social të nominuar është me dominim real dhe objektiv të grave për shkak të specifikës të problematikës e cila po zbatohet. Kjo specifikë është në relacion me atë se numuri më i madh i viktimave të tregëtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë janë gra dhe fëmijë.


2 .A.2

Variabla e dytë për analizë të pyetësorit është lloji dhe shkalla e arsimit të punëtorëve socialë të nominuar nga Qendrat për punë sociale të inkuadruara në MKU.

Shtojcë nr.2

Shkalla e arsimit


Shkalla e arsimit	Numri absolut	%
E lartë dyvjeçare	9	16%
E lartë	47	84%



Shtojcë nr.3

Përfaqësimi sipas profesionit

Lloji i arsimit	Rezultate	
	Numri absolut	%
Punëtor social. Me arsim të lartë dyvjeçar	9	16%
Punëtor social. I diplomuar	44	76%
Sociolog i diplomuar	2	3%
Jurist i diplomuar	2	3%
Psiholog i diplomuar	1	2%



Përfundime

Grupi arsimor dominant në MKU janë punëtorët social me arsim të lartë me 76% dhe ata e përbëjnë skeletin e MKU por megjithatë duhet të kemi parasysh se 16% janë me shkollë të lartë dyvjeçare që përfshin profilin arsimor të zbatuesve në MKU në teren, që do të thotë se ky grup arsimor është në kufi të moshës të tejkaluar dhe gjenden në fund të karrierës së punës.

Rekomandohet ndërim gradual me punëtorët social ekzistues në kuadër të QPS nëse ka ose me inkuadrim të profileve arsimtare të tjera të cilët kanë lidhje me problematikën - tregëtia me njerëz.

2. A. 3.

Variabla e tretë si mjet analize është mosha dhe përvoja e punës të punëtorëve socialë të nominuar dhe ajo është e reflektuar në shtojcën që vijon.

Shtojcë nr.4

Mosha mesatare

Mosha mesatare e bashkëpunëtorëve profesionalë të nominuar në MKU	48 vite
Bashkëpunëtorë profesional më të rinj në MKU	28 vite
Bashkëpunëtorë profesionalë më të moshuar në MKU	62 vite

Stazh pune mesatar

Stazh pune mesatar	20 vite
Stazh pune më i shkurtër	3 vite
Stazh pune më të gjatë	35 vite

Rezultatet tregojnë se kufiri moshatar i personave të nominuar në MKU është mjaft i lartë. Ekipi është tepër e përfaqësuar me persona të moshuar dhe me stazh të gjatë pune që mund të paraqesë pengesë në aktivitetet e ardhshme të parashikuara me MKU duke e patur parasysh specifikën dhe rëndësinë e problematikës të cilën e përfshin Mekanizmi Kombëtar për Udhëzim.

B. Kapacitetet administrativo-teknike dhe gjendjet ku punojnë punëtorët social të nominuar

Dispozicionimi në kuantitet i diturive dhe shkathtësive por edhe aftësite momentale organizuese në 27 Qendrat për punë sociale ku i zbatojnë (bashkëpunëtorët profesional të nominuar të inkuadruar në MKU) obligimet e veta të punës janë parakusht i rëndësishëm për funksionim normal dhe të drejtë të aktiviteteve të MKU

Me atë qëllim në kuadër të pyetësorit një pjesë i është kushtuar kontrollit, por edhe lëndës për analizë të gjëndjeve të tilla.

Para se gjithash këtu duhet patur parasysh përkushtimi organizues në mikro nivel (qendër për punë sociale), dituri dhe shkathtësi për përballim më të mirë të punës tekniko administrative në kuadër të MKU më pas për çfarë e shfrytëzojnë më shumë pjesën më të madhë të kohës së punës, a janë të pregatitur, sa dhe ku i zgjerojnë dituritë dhe shkathtësitë e veta dhe a i kanë të gjitha kushtet e nevojshme për punë efikase dhe efektive në Qendrat për punë sociale.

Në këtë kontekst janë të treguar rezultatet që vijnë nga analiza e zbatuar e zyrës koordinative të MKU.


Keto janë rezultatet nga analizat:

2. B.1


Sa kohë përkushtoni gjatë një dite pune për:	Shkalla e përkushtimit			
A. Puna profesionale	B. Punë administrativo-teknike	C. Punë në teren	Ç. bisedim me kolegët për problemet	
Në përgjithësi nuk përkushtoj	Në përgjithësi nuk përkushtoj	Në përgjithësi nuk përkushtoj	Në përgjithësi nuk përkushtoj	
Përkushtoj aq sa më urdheron puna	Përkushtoj aq sa më urdheron puna	Përkushtoj aq sa më urdheron puna	Përkushtoj aq sa më urdheron puna	
Përkushtohem	Përkushtohem	Përkushtohem	Përkushtohem	
Përkushtohem më së shumti	Përkushtohem më së shumti	Përkushtohem më së shumti	Përkushtohem më së shumti	

Shtojcë. 1


A. Punë profesionale




B. Punë administrative



C. Punë në teren



Ç. Komunikim kolegjial për problemet në QPS



Përkushtimi

i punëtorëve profesionalë gjatë një ditë pune është se ata përkushtohen aq sa i urdhërojnë obligimet e punës. Përfundimet janë se ata dominojnë me mbi 50% dhe se punëtorët socialë të nominuar të inkuadruar në MKU përkushtohen aq sa i urdhëron puna dhe se kjo mund të përgjithësohet se përkushtimi në punë është brenda kornizave të asaj që kërkohet, aq edhe jepet.

Të dhënat ja indikative se punëtorët social të nominuar kanë përgjigje të disperzuar për punën në teren.

Rezultat tjetër indikativ është se puna në ekip dhe sjellja komplementare ndaj obligimeve të punës është në nivel të ulët i cili është një nga parakushtet e rëndësishme për punë me viktimë të tregëtisë me njerëz. Po ashtu në punën me QPS dhe MKU është treguar se puna e tyre është rritur nga karakteri administrativ dhe të dhënat tregojnë se 2% në përgjithësi nuk përkushtohen në punën administrative, kurse 71% aq sa i urdhëron puna.


2. B. 2

Dituri dhe shkathtësi në teknikën kompjuterike janë parakusht i rëndësishëm për komunikim më të shpejtë dhe më të thjeshtë si brenda në mikro njesinë (Qendër për punë sociale) por po ashtu edhe me zyrën koordinative të mekanizmit Kombëtar për udhëzim dhe me vetë Ministrinë për punë dhe politikë sociale. Kjo para së gjithash thekson se zyra e MKU ka data bazë në formë elektronike dhe në formë të shtypur të viktimave potenciale të identifikuar të tregëtisë me njerëz. Nga këto arsye njohuria e disa mjeteve është e rëndësishme për komunikim pa pengesa. Në shtojcë i paraqesim të dhënat e përpunuara që fituam:

Shtojcë. 2


Sa i shfrytëzoni shkathtësitë kompjuterike që vijnë?	Shkallë e shfrytëzimit				
	Në përgjithësi nuk i shfrytëzoj	Nuk i shfrytëzoj	Nuk më interesojnë	I shfrytëzoj	I Shfrytëzoj shumë
Word	13%	7%	0%	48%	32%
Internet	38%	22%	0%	35%	5%
Power Point	57%	33%	0%	10%	0%
Excel	38%	30%	0%	29%	3%
Vlera Mesatare	37%	23%	0%	13%	31%

V L E R A M E S A T A R E



Enter

Nga rezultatet e vlerave mesatare mund të shikohet se në dituritë e tyre për shkathtësi kompjuterike kanë karakter disproporcional, d.m.th. lëvizin në relacion nga shumë shfrytëzojnë deri në përgjithësi nuk i shfrytëzojnë. Për kontroll më të detajshëm mund të shikohet tabela dhe treguesit grafik.




2. B. 3

Shtojcë. 3

Tranjimi si mënyrë e zgjerimit të diturive dhe shkathtësive

A vizitoni tranjime?		
Përgjigje	Vlera Mesatare	%
1. Regullisht vizitoj dhe vetë investoj në tranjim	10	18%
2. Vizitoj tranjime vetëm në qoftë se janë pa pagesë	1	2%
3. Vizitoj tranjime vetëm në qoftë se më kërkohet nga personat kompetentë	41	71%
4. Tranjimet nuk janë të rëndësishme	1	2%
5. Nuk duan të përgjigjen	4	7%



Investimi në dituri dhe shkathtësi të reja është një nga parakushtet për kumtimin e çështjeve sociale dhe për to gjithmonë duhen informacione si për dukuritë po ashtu edhe për hyrje me kohë drejt identifikimit dhe bërballjes.


Rezultatet flasin se në kuadër të QPS investimi nga profesioni dhe puna e tyre ka karakter të rreptë hierarchie d.m.th. ajo është vendimtare nga drejtuesit e QPS ose personat e tjerë përgjegjës në kuadër të institucionit. Vetinvestimi dhe paraqitja e një shkalle më të lartë dhe zgjerimi i profesionalizmit është zëvendësuar me njohuri të reja.

2. B .4

Shtojcë 4

A janë të nevojshme paisje plotësuese për funksionim më të mirë të punëtorëve social të nominuar?

A e keni paisjen e duhur për punë evektive?		
Përgjigje	Numri absolut	%
Po	22	44
Jo	24	40
Nuk ka përgjigje	9	18



Në kuadër të MKU është bërë donacion me paisje kompjuterike për 15 QPSM për punë me viktime të tregëtisë me njerëz (nga gjithësej 27 QPSM) dhe rezultatet vetëm e vërtetojnë këtë të dhënë. Por dëshirë e bashkëpunëtorëve profesionalë të nominuar është të jenë të paisur me (shumica u deklaruan për telefona celularë) kurse ndonjëri me automjet për punë më efikase kurse shumë pak u deklaruan për paisje plotësuese kompjuterike.

C. Vetidentifikim me MKU


Vetidentifikimi mbi vlerësimin real të bashkëpunëtorëve të nominuar të inkuadruar në MKU dhe qëllimi i tyre të marin pjesë në aktivitetet e ardhshme në kuadër të MKU është qëllimi i kësaj pjese të analizës. Rezultatet kanë për qëllim të nxjerrin të dhëna për atë se sa bashkëpunëtorët e nominuar kanë për qëllim të aktivizohen në MKU duke i pranuar qëndrimet e tyre por nga ana tjetër ta tregojnë mendimin e vetë për atë se çfarë është bërë më parë nga ana e MKU në shfrytëzim material të tyre.

Sa i pranuan MKU dhe si deklarohen në këtë kontekst.

2. C. 1

Shtojcë. 1

A i keni të qarta detyrat dhe obligimet të cilad dalin prej MKU?		
Pergjigje	Numri absolut	%
Apsolutisht janë të qarta	48	86%
Ka disa obligime jo mjaftë të qarta	3	5%
Janë tepër të komplikuar	0	0%
Nuk përkasin me arsimin dhe punën time	2	4%
Nuk duan të përgjigjen	3	5%




2. C. 2.

Shtojcë. 2

Nevojë për tranjim plotësues dhe fitim të njohurive të reja në fushën e luftës kundër tregëtisë me njerëz

A keni nevojë për tranjim plotësues?		
Pergjigje	Numri absolut	%
Po	43	78
Jo	7	13
Nuk duan	5	9

A keni nevojë për tranjim plotësues?



Përgjigje për atë se për çfarë lloj tranjim plotësues kanë nevojë bashkëpunuesit e nominuar:


1. Metoda dhe teknika të reja për punë me viktimë të tregëtisë me njerëz
2. Punë individuale me fëmijë viktimë të tregëtisë
3. Punë me familje
4. Vizita studiuëse
5. Zhvillim të bashkëpunimit me vetëqeverisjen vendore, policinë, sektorin joqeveritar etj.

Po ashtu në kuadër të MKU janë realizuar vizita gjyqësore në Bullgari, Shqipëri dhe Sërbi me qëllim që të fitohen përvoja të caktuara për atë se si funksionon dhe si është vendosur MKU në vendet e tyre. Me këtë qëllim MKU bëri analizë se sa ata janë të kënaqur nga vizita studiuëse.

2.C.3

Shtojcë 3


A keni patur vizitë studiuëse jashtë vendit të organizuar nga MTSP/MKU		
Përgjigje	Numri absolut	%
Po	17	30
Jo	35	63
Nuk kanë përgjigje	4	7



2. C. 4

Shtojcë 4


Sa jeni të kënaqur nga vizita studiuëse?		
Përgjigje	Numri Absolut	%
Apsolutisht të pakënaqur	0	0%
Të pakënaqur	0	0%
Pjesërisht të kënaqur	3	17%
Të kënaqur	8	44%
Shumë të kënaqur	7	39%



2. C. 5

Shtojcë. 5

A dëshironi të jeni angazhuar si person profesional i nominuar në Mekanizmin Kombëtar për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz?		
Përgjigje	Numri Absolute	%
Po dëshiroj	32	58%
Dëshiroj, por jam i penguar nga shkaqe objektive	3	5%
Dëshiroj, por jam i penguar nga shkaqe subjektive	4	7%
Nuk dua	14	25%
Nuk përgjigjen	3	5%



Përfundime

A. Karakteristikat social-profesionale të punëtorëve socialë të nominuar

Nga të dhënat e fituara mund të përgjithësohet se nga punëtorët social të nominuar 66% janë gra, 84% janë me arsim të lartë, moshë mesatare është 48 vjeç (më i ri është 28 vjeç kurse më i vjetri është në moshë 62 vjeçare) dhe me stazh mesatar pune prej 20 vjetësh. Megjithatë duhet të shënohet se 24% nuk janë punëtorë social, por janë profesionistë nga QPS prej profileve të tjera përkatësisht psikologë, sociologë dhe juristë.

B. Kapacitetet administrative dhe kushtet në të cilët punojnë punëtorët social

- Në përgjithësi u arrit në konkluzionin se sa urdhëron puna është përgjigje më e shpeshtë e pyetjeve se sa i përkushtohen punës profesionale 36%, puna administrative teknike 71%, puna në teren 29% dhe bëj bisedë me kolegët për problemet 48%.
- Sa i përket shfrytëzimit të programeve kompjuterike është simptomatike se si vlerë mesatare u deklaruan 37% absolutisht nuk i shfrytëzojnë kurse 23% nuk i shfrytëzojnë.
- Më shumë shfrytëzohet Word 32%. Është pozitive që asnjëri nuk u deklarua për opsionin "nuk më interesojnë". Indikative është që 71% përgjigjen se shkojnë në tranjim vetëm nëse u është urdhëruar nga përgjegjësit.
- Të ndara janë mendimet rreth nevojës nga paisje teknike për punë efektive, përkatësisht QPS në të cilat nuk ishin paisur zyrtarët 40% deklaruan se kanë nevojë për paisje teknike të zyrave.
- Një numër më i madh e parashtuan nevojën e telefonave celularë zyrtarë për funksionim më të suksesshëm.

C. Vetidentifikim me MKU

- 86% deklaruan se absolutisht janë të qarta detyrat dhe obligimet që dalin nga angazhimi i Mekanizmit Kombëtar për udhëzim kurse 5% se nuk janë përkatës për arsimin e tyre.
- 78% konsiderojnë se kanë nevojë dhe dëshirojnë tranjim plotësues. I gjërë është spektri i përgjigjeve të pyetjes për tipin e tranjimit dhe janë paraqitur shumë fusha siç janë: metoda dhe teknika të reja për punë me viktimë të tregëtisë me njerëz, punë individuale me fëmijë viktimë të tregëtisë, punë me familje, vizita studiu, zhvillim i bashkëpunimit me vetëqeverisjen vendore, policia, sektori joqeveritar etj.
- Në vizitat studiu të organizuara nga ana e MKU, 30% të punëtorëve social të nominuar ishin inkuadruar dhe prej tyre 39% përgjigjen se janë shumë të kënaqur, 44% të kënaqur dhe 17% pjesërisht të kënaqur.
- 58% deklaruan se dëshirojnë të inkuadrohen në MKU, 5% nuk ju përgjigjen kësaj pyetjeje dhe 25% u përgjigjen se nuk dëshirojnë të nominohen për punën në këtë problematikë.



RAPORTI PËR RREGULLATIVËN EKZISTUESE LIGJORE

Rekomandime për ndryshime dhe plotësime nga aspekti i mbrojtjes së viktimave të tregtisë me njerëz për funksionim më të suksesshëm të Mekanizmit Nacional për Udhëzim

HYRJA

Mbrojtja e të drejtave të njeriut që janë lëndë të tregtisë me njerëz është me e rëndësishme nga të gjitha masat për luftë kundër tregtisë me njerëz. Mekanizmi për mbrojtje duhet të përfshijë qark të gjerë të shërbimeve të ndryshme të specializuara, që fokusohen në nevojat konkrete të çdo individi.

Hapi kryesor drejt njohjes së dinjitetit njerëzor të njerëzve që janë lëndë të tregtisë me njerëz dhe pranimi se ato janë viktimë e jo kriminelë, është që viktimave t'u lejohej qasje në vendosje, përkujdesje të specializuar mjekësore dhe psikologjike, këshillime, ruajtje dhe leje për punë dhe për vazhdim të arsimit ose aftësisë. Personave që janë lëndë të tregtisë me njerëz duhet t'u sigurohet qasje në shërbimet e specializuara, siç është intervenimi gjatë krizës, këshillimi afatgjatë psikologjik, konsultimet juridike, aftësimi profesional dhe përkrahja gjatë qasje në mundësitë e punësimit.

Të gjitha këto aktivitete paraqesin qëllim kryesor të Mekanizmit nacional për udhëzim (MNU) që do të veprojë në drejtim të përfundimit të aftësisë së vendit në sigurimin e identifikimit përkatës, ndihmës dhe mbrojtjes, në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejta njerëzore, të gjithë viktimave gjatë tregtisë me njerëz shtetas të Republikës së Maqedonisë, veçanërisht adoleshentëve, pa dallim të përkatësisë së tyre nacionale, etnike, moshës dhe gjinisë.

MNU do ta përmirësojë dhe përforcojë mbrojtjen dhe shërbimet për ndihmë që i kanë në dispozicion për viktimat, parimisht grave, vajzave, pakicave dhe adoleshentëve, ndërsa në mënyrë të veçantë do të kontribuojë në aktivitetet tjera në luftën kundër tregtisë me njerëz, siç është ndihma e drejtpërdrejtë e viktimave të tregtisë me njerëz dhe ngritjes së vetëdijes publike.

Partnerë kryesorë për bashkëpunim të MNU janë: Komisioni nacional (përfshirë Sekretariatit dhe Nëngrupi për luftë kundër tregtisë me fëmijë), Ministria e Punëve të Brendshme, rrjetet joformale të OJQ-ve për luftë kundër tregtisë me njerëz, Unioni i punëtorëve socialë, koalicionet komunale për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe komisionet komunale për barazi gjinore. Si partnerë plotësues përfshihen entitetet relevante ndërkombëtare, nacionale dhe shtetërore.

Lufta kundër tregtisë me njerëz kërkon qasje multidisiplinare dhe ndërsektoriale, në të cilin do të përfshihen aktorët relevantë nga qeveria dhe nga shoqëria qytetare. Struktura për luftë kundër tregtisë me njerëz duhet të bëjë vlerësim dhe të ndërtojë kapacitetin ekzistues nacional me qëllim që të nxitë pronësinë dhe mirëmbajtjen.

Për sigurim efektiv të të drejtave njerëzore të viktimave dhe për mirëmbajtje afatgjate duhet të ndërtohet struktura e vendit gjegjësisht institucionet qeveritare dhe shoqëria qytetare.

Infrastruktura për luftë kundër tregtisë me njerëz duhet të funksionojë në bazë të definicionit të gjerë për luftë kundër tregtisë me njerëz që të mund shpejtë të përgjigjet në format e ndryshme të tregtisë me njerëz.

Për funksionim më të suksesshëm të Mekanizmit nacional për udhëzim të viktimave të tregtisë me njerëz është bërë analizë, me parapëlqime për ndryshime dhe plotësime të ligjeve vijuese:

1

KODI PENAL I RM-së (Gazeta zyrtare e RM numër 37/96 80/99, 4/02, 43/03 dhe 19/04);

2

LIGJI I PROCEDURËS PENALE TË RM-së (Gazeta zyrtare e RM numër 4/90, 74/04 dhe 15/2005);

3

LIGJI I FAMILJES (Gazeta zyrtare e RM numër 80/92, 9/96 dhe 83/04; tekst i korrigjuar - Gazeta zyrtare e RM numër 83/04) dhe NDRYSHIME DHE PLOTËSIME TË LIGJIT TË FAMILJES (Gazeta zyrtare e RM numër 33/06);

4

LIGJI I MBROJTJES SOCIALE (Gazeta zyrtare e RM numër 50/97, 16/2000, 17/03, 62/05 dhe 111/05) TEKST I KORRIGJUAR (Gazeta zyrtare e RM nr.21/06);

5

LIGJI I MBROJTJES SË FËMIJËVE (Gazeta zyrtare e RM nr.98/2000, 17/2003, 65/2004 dhe 113/2005); dhe

6

LIGJI I QASJES SË LIRË NË INFORMACIONE (Gazeta zyrtare e RM nr.13 të 01.01.2006).

KODI PENAL DHE LIGJI I PROCEDURËS PENALE

NENI 418-A, KODI PENAL

Për ballafaqim më të suksesshëm me tregtarët me njerëz, ndërsa njëkohësisht për plotësimin e legjislacionit të vendit me konventën e ratifikuar të KB-ve kundër krimit të organizuar transnacional dhe protokolleve të saja me ndryshimet e Ligjit penal në vitin 2002 u shtua neni i ri 418a me titullin Tregtia me njerëz. Në vitin 2004 në Ligjin penal janë bërë ndryshime, me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të kodit penal neni 418-a u ndryshua dhe i neni në fjalë thuhet:

1)Ai që me dhunë, kërcënim serioz shpie në lajthim ose në formë tjetër të dhunës, vjedhjes, mashtrimit, me keqpërdorim të pozitës së tij ose gjendje shtatzënie, pafuqi ose pa aftësi fizike ose mentale të tjetrit, ose dhënie ose pranim të të hollave ose shfrytëzim tjetër për shkak të marrjes së pëlqimit të personit që ka kontroll ndaj personit tjetër gënjen, transporton, bart, blen-shet, strehon ose pranon persona për eksploatim përmes prostitucionit ose formave tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë të dhunshme ose shërbim, robëri martesë të dhunshme, fertilizim të dhunshëm, birësim jo ligjor ose marrëdhënie tjetër ose transplantime nga pjesët e trupit të njeriut pa leje do të dënohet me dënim me burg së paku katër vjet.

2)Ai që gënjen, transporton, bart, blen - shet, strehon ose pranon fëmijë ose persona adoleshentë për eksploatim, do të dënohet me burg së paku tetë vjet.

3)Ai që do të merr ose shkatërrojë letërnjoftim, pasaportë ose dokument tjetër identifikimi të huaj për realizimin e veprës nga paragrafët 1 dhe 2 do të dënohet me burg së paku prej katër vjetësh.

4)Ai që përdor ose mundës që tjetri të përdor shërbime seksuale nga personi që e di se është viktimë e tregtisë me njerëz, do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri pesë vjet.

5)nëse vepra nga paragrafi 4 është bërë me person adoleshent, dorasi do të dënohet me burg së paku prej tetë vjetësh.

6)Nëse veprën nga paragrafi 1 e bën personi juridik, do të dënohet me dënim në të holla.

7)Gjërat dhe mjetet transportuese të përdorura për realizimin e veprës konfiskohen.

Nga gjithë ajo e paraqitur më lartë mund të vërtetohet se Republika e Maqedonisë përmban rregullativë të pasur ligjore kur bëhet fjalë për inkriminimin e veprave penale në lidhje me tregtinë me njerëz. Megjithatë, parashtrohet pyetja, gjithë këto dispozita a janë zbatuar në praktikë në gjykatat e vendit, a janë diferencuar qartë ndërmjet vete, përkatësisht a ekzistojnë përshkrime të forta dhe të qarta të pranimeve ligjore dhe cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen organet kompetente gjatë kualifikimit të veprimit të caktuar nën normën e caktuar.

REKOMANDIME

Definicioni ligjor i tregtisë me njerëz në Kodin e tanishëm penal (KP) është zgjeruar dhe krijon pengesa gjatë caktimit dhe dëshmimit të elementeve të dhunshme në praktikë.

1.Neni 418-a e parasheh si rrethanë të rëndë, gjendjen kur janë përfshirë fëmijët ose personat adoleshentë, por edhe më tej kërkon të ekzistojnë mjete të dhunës përmes ekzistimit të synimit për eksploatim, duke përdorur shprehjen si eksploatim. Nga këtu del se neni 418-a kur bëhet fjalë për fëmijë parasheh rrethanë të rënduar nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër kërkon të ekzistojë edhe element i dhunshëm, përkatësisht dedikim për eksploatim.

Me shtimin eventual të nenit duhet të sqarohet fakti se në çfarë situatë ka qenë me këtë përshkrim dhe e cila përfshin fëmijë ose person adoleshent, ekziston vepër penale tregti me njerëz edhe krahas asaj që nuk është patjetër të ekzistojë asnjë nga mjetet e dhunshme.

Me fjalë të tjera nevojitet dispozitë eksplicite e cila do ta përfshijë domosdoshmërinë që të dëshmohet nevoja e elementeve të njëjta të dhunshme kur bëhet fjalë për fëmijë - viktimë, ndërsa të cilat janë të domosdoshme për ekzistimit të viktimat e moshës madhore. Gjithashtu, vepra penale nuk duhet të përfshihet vetëm në eksploatimin seksual të fëmijës, por edhe në format tjera të fshehura të eksploatimit me punë të fëmijës të cilët gjithashtu duhet të jenë të inkriminuara.

2.Të parashihet si formë e kualifikuar e veprës penale tregti me fëmijë, nëse vepra është bërë nga ana e prindërve.

3.Në nenin 418-a të tanishëm të KP mungon dispozita që do ta përjashtonte relevancën e deklaratës për pajtim të viktimës. Në të drejtë, neni 418-a parasheh domosdoshmërinë e dispozitës që përjashton pëlqimin deklaratën e viktimës. Nevojitet që të përbëhet klauzolë e veçantë e cila këtë vepër penale që pajtimi (vetëdijen) i viktimës të jetë e ekspozuar në eksploatim do ta konsiderojë si jo relevante, ndërsa elementet e dhunës padyshim të ekzistojnë.

Praktika tregon se deklarata e viktimave me të cilat ata e tregojnë pëlqimin e tyre të jenë të eksploatuar në një numër të madh u pranuan si rrethanë e lehtësuar përmes së cilës në tërësi merrej ose zvogëlohej përgjegjësia e dorasëve të këtyre veprave. E gjithë kjo ka kontribuar bollëk në praktikë me kualifikime jopërkatëse juridike në raste të këtilla ku veprat me këtë element preferohen të procesohen si vepra të ndërmjetësimit në prostitucion (neni 191 i Kodit penal). Për shkak se deklarata konsiderohet si gjëra më kryesore për ngritjen e akt-akuzës dhe për udhëheqjen e procesit gjyqësor, është e qartë se deklarata e viktimës me pëlqim të shprehur vetëm shkon në dobi të tregtarit me njerëz edhe krahas faktit që vetë pëlqimi i viktimës asesi nuk duhet ta prevenojë vënien dhe përndjekjen hetuese.

4.Në nenin 418-a nuk ekziston dispozitë eksplicite për dënim në tentim. Do të ishte e rëndësishme të mendohet që në të ardhmen e afërt të plotësohet neni 418-a me

një dispozitë më eksplicite dhe më të qartë për dënim për tentim, me çka do të zvogëloheshin mundësitë për jokonsekuencat e ardhshme eventuale në praktikë për dënim të tregtarëve me njerëz.

5.Tregtia me njerëz të parashihet si vepër e veçantë penale.

6.Në legjislativin e Maqedonisë në vend të termit viktimë në përgjithësi përdoret termi i/e dëmtuar edhe atë si në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë, ashtu edhe në ligjin në proces përkatësisht në Ligjin e procedurës penale.

Në këtë drejtim ligjdhënësi nën termin viktimë që paraqitet në cilësinë e të dëmtuarit nënkupton person të cilit me vepër penale i është dëmtuar e drejta ose është rrezikuar ndonjë e drejtë personale ose pronësore e tij, që posedon informacione të rëndësishme për procedurë penale me dhënien e të cilave jeta, shëndeti, liria, integriteti fizik ose pasuria më e madhe e tij do të ishin në rrezik dhe e cila është pajtuar me dhënien e shprehjes në cilësinë e dëshmitarit në procedurën penale të bashkëpunojë me organet e drejtësisë.

• • • • •

NENI 243 DHE 244, LIGJI I PROCEDURËS PENALE

Është i domosdoshëm respektimi i dispozitave nga neni 243 dhe 244 të LPP në pajtim me të cilët dëshmitari do të rekomandohet se nuk është i obliguar të përgjigjet në pyetje të caktuara nëse është e mundur me këtë veten ose të afërm të tij të shpie në turp të rëndë, dëm material ose ndjekje penale.

Neni 243 i LPP:

Gjatë marrjes në pyetje të personit adoleshent, veçanërisht nëse ai është i dëmtuar me vepër penale, do të veprohet me kujdes në mënyrë që marrja në pyetje të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen psikike të adoleshentit. Nëse ajo është e nevojshme, marrja në pyetje e adoleshentit do të bëhet me ndihmën e pedagogut ose personit tjetër profesional.

Neni 244 i LPP:

(1)Nëse ekziston mundësia se me paraqitjen e rrëfimit ose me përgjigje në pyetje të caktuar dëshmitari do të vinte veten ose person të afërt në rrezik serioz për jetë, shëndet ose integritet fizik, dëshmitari mund të shkurtojë paraqitjen e të dhënave.

(2)Nëse dëshmitari shkurton paraqitjen e të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni avokati publik, gjykatësi hetues përkatësisht kryetari i këshillit nëse vlerëson se është themeluar ekzistimi i rrezikut nga paragrafi 1 i këtij neni do të ndërpresë hetimin dhe në afat prej 24 orësh do të ndërmerr veprime në pajtim me nenin 249 të këtij ligji.

REKOMANDIME

1. Deklaratën personi adoleshent patjetër ta japë në prani të personit profesional - punëtor social, psikolog ose avokat.

2. Gjatë marrjes në pyetje të fëmijës - viktimë opinionin patjetër duhet të jetë i përjashtuar.

3. Nëse ekziston mundësia se me dhënien e rrëfimit ose me përgjigjet e disa pyetjeve, dëshmitari - viktimë veten ose person të tij të afërt do të shpinte në kërcënim serioz, dëshmitari duhet (patjetër) të ketë të drejtë që jo vetëm të refuzojë të tregojë emrin dhe adresën, por në përgjithësi të mos tregojë (bile përderisa nuk ndërmerren masa që do të garantonin jetën e tij, integritetin fizik dhe privat). Në këtë kuptim duhet të ndryshohet neni 244 i LPP.

Atëherë kur pushtetarët kompetentë do të konsiderojnë se ekziston kërcënim serioz për rrezikim ose presione ose do të kenë dëshmi valide për qëllim serioz për prekje private të dëshmitarit, duhet të ndërmerren masa përkatëse para, gjatë dhe pas gjykimit. Mes tjerash, pushtetarët kompetentë duhet të sigurojnë që t'u shmangin kontaktet e panevojshme ndërmjet viktimave, dëshmitarëve dhe të akuzuarve. Për këtë qëllim patjetër duhet të sigurohen lokale të veçanta për dëshmitarët dhe viktimat në të cilat do të ndjehen të sigurt, të mbrojtur nga kërcënimet, ofendimet dhe presionet.

4. Dëshmitarëve - viktimave duhet t'u sigurohen masa alternative për dhënien e thënies me çka do t'i mbrojnë nga kërcënimet dhe presionet të cilat mund të rezultojnë nga ballafaqimi sy më sy edhe atë:

- incizim i deklaratave të dëshmitarëve - viktimave në procedurën paraprake me mjete audio-vizuale;
- mundësim të dëshmitarëve-viktimave të japin thëniet nga hapësirë e veçantë me përdorim të video-linjës;
- përgjashtim të mediave ose opinionit nga një pjesë ose i gjithë gjyqit.

NENI 97, LIGJI I PROCEDURËS PENALE

Kompensimi i viktimës së tregëtisë me njerëz është i mundur përmes shfrytëzimit të institutit konfiskimit të pasurisë ose dobisë poseduese nga dorasi i veprës penale dhe kthimi në dobinë e të dëmtuarit, përkatësisht viktimës në procedurën penale.

NENI 97 i LPP

(1) Kërkesa juridike pronësore që është bërë për shkak të realizimit të veprës penale do të debatohet me propozim të personave të autorizuar në procedurën penale, nëse me këtë nuk do të prolongohet kjo procedurë.

(2) Kërkesë juridike pronësore mund të përkasë në kompensimin e dëmit, në kthimin e gjerave ose në anulimit të ndonjë pune të caktuar juridike.

REKOMANDIME

1. Në kuptimin e përkrahjes përkatëse të institucioneve të sistemit, është e rëndësishme të mendohet për themelimin e ndonjë lloj mekanizmi nacional për përkrahjen dhe plotësimin e kërkesave për dëmtimet na ana e viktimave, me ekzistimin e ndonjë fondi nga i cili do të alimentoheshin nevojat e viktimave për riintegrimin e tyre social, përmes së cilit, gjithashtu do të përkraheshin edhe shërimet efektive juridike dhe zhdëmtimin e të gjithë atyre viktimave të procesuara. Me koncentrimin e pasurisë dhe mjetet e marra nga dorasi i veprave të tregëtisë me njerëz, në bazë të procedurave të zbatuara vijuese penale, mekanizmi i këtillë nacional për përkrahje në të shumtën e raste do t'i ndihmonte shtetit në tejkalimin e problemeve kronike dhe buxhetore në financimin e aktiviteteve në luftën kundër tregëtisë me njerëz dhe programet eventuale sociale riintegruese të viktimave të ndërmarra në kontekst nacional.

Respektimi i dispozitave të Ligjit për procedurë penale që i përkasin kërkesës juridike pronësore paraqet imperativ të domosdoshëm për sigurimin e mbrojtjes së interesit të viktimës, përkatësisht përforcimit të pozitës në procedurën para gjyqit.

2. Shfrytëzimi i gjykimit (ekspertizës) së personave profesionist që janë të obliguar në dhënien e përkrahjes psiko-sociale të viktimave menjëherë pas pranimit të tyre në strehimore, si mjet dëshmues në procedurë,

veçanërisht në kushte që nuk është bërë ekspertizë tjetër në gjendjen psikologjike të viktimës, paraqet vendim të dëshiruar për vërtetimin e bazës dhe shumën e kompensimit të drejtë të viktimës së tregëtisë me njerëz.

Mbrojtja efektive juridike e viktimave të tregëtisë me njerëz është parakusht themelor për integrim social të suksesshëm të tyre, jo vetëm në aspektin e rezultateve të procedurave të udhëhequra dhe dënim-it të dorasëve, por edhe nga aspekti i plotësimin të drejtësisë dhe në këtë kuptim realizimin e kërkesës përkatëse dëmtuese të viktimës si kompensim i posaçëm për vuajtjet e pësura.

LIGJI I FAMILJES

Me Ligjin e familjes (LF) rregullohen martesat dhe familja, marrëdhëniet në martesë dhe familje, forma të caktuara të mbrojtjes së veçantë të familjes, marrëdhëniet e prishura, dhuna në martesë dhe familje, birësimi, kujdestaria, ruajtja etj.

NENI 6, LIGJI I FAMILJES

Neni 6 i LF i përket familjes dhe në të qëndron:

Martesa me ligj është bashkësi e rregulluar e jetës së burrit dhe gruas në të cilën realizohen interesat e partnerëve, familjes dhe shoqërisë.

Marrëdhëniet ndërmjet partnerëve bazohen në vendimin e lirë të burrit dhe gruas të lidhin martesë, në bazë të barazisë së tyre, respektimit të ndërsjellë dhe ndihmës së përbashkët.

3. Ekipi profesional të përgatisë program të veçantë për çdo fëmijë adoleshent për ndërmarrjen dhe ndjekjen e masave të mbikëqyrjes së ushtrimit të së drejtës prindërore.

4. Në program të parashihet bashkëpunimi me institucione të tjera (shëndetësi, arsim, agjencia e punësimit etj.) për risocializim të plotë.



NENI 167-190 DHE 191-196, LIGJI I FAMILJES

Menjëherë pas identifikimit të fëmijës viktimë Qendra për punë sociale duhet të emërojë kujdestar me obligim zyrtar që do të kujdeset për mbrojtjen e person-alitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës dhe do t'i shoqërojë gjatë gjithë procesit derisa nuk gjendet zgjidhje e qëndrueshme në interes më të mirë të fëmijës.

Në Ligjin e familjes ekziston kreu i posaçëm i emëruar Kujdestari (Neni 167-190) dhe Kujdestaria ndaj personit adoleshent (neni 191-196)

Neni 167, Ligji i familjes:

Personit nën kujdestari qendra për punë sociale i cakton kujdestar, nëse nuk vendos që detyrën e kujdestarit ta ushtron drejtpërdrejtë.

Për kujdestar caktohet personi i cili ka cilësi dhe aftësi personale për ushtrimin e obligimit të kujdestarit, ndërsa i cili patjetër do të jep pëlqim që të jetë kujdestar.

Për kujdestar caktohet i afërmi i personit që është nën kujdestari.

Gjatë caktimit të kujdestarit qendra për punë sociale i merr parasysh edhe dëshirat e personit që është nën kujdestari, nëse është në gjendje të shpreh atë, si dhe dëshirat e të afërmeve të tij.

Me kujdestarinë, Republika iu jep mbrojtje personave adoleshentë të cilët janë pa përkujdesje prindërore ose personave të moshës madhore të cilëve iu është mohuar ose kufizuar aftësia vepruese. Mbrojtje ju jepet edhe personave të tjerë të cilët nuk janë në gjendje ose nuk kanë mundësi vet të kujdesen për mbrojtjen e interesave të tyre. Procedura për vënien e fëmijës nën kujdestari, caktimin e masave dhe mbrojtjen e personit, të drejtat dhe pasuria e personit adoleshent, caktimi i kujdestarit, ushtrimit të mbikëqyrjes ndaj kujdestarit në ushtrimin e detyrës së kujdestarisë e bën Qendra për punë sociale, si organ i vetëm kompetent për kujdestari.

Qendra për punë sociale gjithashtu është e autorizuar të vazhdojë të ofrojë ndihmë personave të cilëve kujdestaria iu është ndërprerë për shkak të moshës madhore, nëse ajo derisa ka zgjatur kujdestaria nga shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur të aftësohet për jetë dhe punë të pavarur.

Neni 191, Ligji i familjes

Nën kujdestari vihet personi adoleshent pa përkujdesje prindërore. Fëmija pa përkujdesje prindërore

është fëmijë prindërit e të cilit nuk janë gjallë, që janë zhdukur, të panjohur ose që janë me vendban-

im të panjohur më tepër se një vjet ose fëmijë prindërit e të cilit pavarësisht nga shkaqet përkohësisht

ose në një afat më të gjatë nuk i realizojnë të drejtat dhe detyrat e tyre prindërore.

Personit adoleshent mund t'i caktohet kujdestar për rast të veçantë kur udhëhiqet kontest ndërmjet fëmijës dhe prindërve të tij, për caktimin e disa veprave juridike ndërmjet tyre, si dhe në raste të tjera kur interesat e tyre janë në kundërshtim. Prindi mund të disponojë me pasurinë e fëmijës adoleshent, ta tjetërsojë, ngarkojë, të heqë dorë nga dhurata ose trashëgimia, vetëm me leje nga qendra e punës sociale.

QPS ndërmerr masa për:

- çdo fëmijë që është pa prindër ose prindërit nuk kujdesen për të, të cilit i nevojitet mbrojtje, qendra për punë sociale menjëherë e cakton nën kujdestari;
- cakton kujdestar të fëmijës dhe vendos për autorizimin e kujdestarit;
- merr vendim që detyrën e kujdestarit ta ushtrojë me obligim zyrtar;
- vendos për ndërrim dhe shkarkim të kujdestarit;
- e informon ofiqarin për caktimin e fëmijës nën kujdestari dhe organin kompetent për evidentimin e pasurisë (kadastrën) nëse fëmija posedon pasuri të patundshme;
- bën regjistrimin e pasurisë së personit nën kujdestari;
- kujdestarit i jep udhëzimet në përkujdesjen e fëmijës dhe pasurisë së tij;

-e shqyrton raportin e kujdestarisë;

-shqyrton ankesa nga persona të tretë për ushtrimin e detyrës së kujdestarisë së kujdestarit;

-vendos se a do të vendoset fëmija në institucion ose familje për përkujdesje, ku detyrën e kujdestarisë QPS e ushtron drejtpërdrejtë;

-bartë vendim për ndërrimin e formës së mbrojtjes së fëmijës, duke u nisur nga nevojat e tij dhe nga interese si më i mirë i tij. Në çdo rast qendra është e obliguar të kujdeset për fëmijën, për të drejtat dhe interesat e tij, zhvillimin e mëtejshëm, arsimin dhe plotësimin e nevojave të tij.

Parimet e udhëheqjes së procedurës:

-QPS e udhëheq procedurën me detyrë zyrtare;

-QPS bashkëpunon me institucione sociale, shëndetësore, arsimore-edukative;

-Vendos sipas njohurive për ndërmarrjen e masave të kujdestarit të fëmijës nga ofiqari, organi shtetëror i cili në ushtrimin e detyrës zyrtare ka ardhur deri te këto njohuri, anëtar i afërm i familjes, fqinj, persona të tjerë juridikë, institucione, bashkësi vendore.

-Për kujdestar caktohet parimisht i afërm i fëmijës, ku merret parasysh edhe dëshira e fëmijës nëse mund të shprehë një gjë të tillë.

REKOMANDIME

1.Fëmijëve viktimë të tregëtisë me njerëz të cilët janë pa prindër ose përkujdesje prindërore, ose janë fëmijë nga shtet tjetër, patjetër iu caktohet kujdestar - person profesional nga ana e qendrës për punë sociale.

2.Për kujdestar do të caktohet person i cili ka kaluar trajnim të specializuar për përkujdesje dhe punë me fëmijë-viktima të tregëtisë me njerëz që posedon profesionalizim përkatës, njohje dhe kuptim të të drejtave të posaçme dhe nevojave të fëmijëve viktimë.

3.Përgatitja e fëmijëve viktimë të tregëtisë me njerëz të kthehen në jetën normale në familjen e tij e cila në mënyrë të drejtë do të kujdeset për zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës, por me mbikëqyrje të vazhdueshme nga ana e ekipit profesional nga qendra për punë sociale të përbërë nga punëtori social, psikologu dhe punëtori shëndetësor.

4.Nëse nuk ka kushte për kthimin e fëmijës në familjen e tij si zgjidhje parësore të parashihet vendosje në familje tjetër, e cila në mënyrë të veçantë është e aftësuar për përkujdesje me kategori të këtillë të fëmijëve.

5.Formimi i ekipit multidisiplinor i cili do të bëjë vlerësimin e nevojave individuale të çdo fëmije - viktimë me qëllim që të caktohen masat e kujdesit dhe mbrojtjes, si dhe të ndjek gjendjen e fëmijës pas kthimit të tij në familje, ose vënies së tij nën përkujdesje alternative.

6.Kujdestari që caktohet mbi fëmijët adoleshentë - viktimë të tregëtisë me njerëz duhet t'i ketë detyrat vijuese:

-Të sigurojë që vendimet që merren gjatë gjitha fazave të procedurës të jenë në interes më të mirë të fëmijës;

-Të sigurojë që fëmija viktimë të ketë ndihmë shëndetësore dhe psiko-sociale dhe mbrojtje si dhe ta shoqërojë deri në vendin e siguritë të vendosjes;

-Të sigurojë që fëmija viktimë të ketë ndihmë të përkohshme juridike dhe mbrojtje si dhe informacione lidhur me statusin e tij, të drejta dhe obligime të cilat i ka sipas legjislacionit të Maqedonisë, nga ana e avokatëve të cilët kanë kaluar trajnim përkatës;

-Të siguroj se fëmija viktimë të gjitha informacionet do t'i marrë në gjuhën e tij amtare;

-Të kontribuojë drejt gjetjes së zgjidhjes së qëndrueshme në interes më të mirë të fëmijës;

-Të jetë lidhje ndërmjet fëmijës viktimë dhe organeve qeveritare dhe institucioneve dhe organizatave joqeveritare të cilat do të mund t'u japin shërbime fëmijës;

-T'i ndihmojë fëmijës viktimë në procesin e gjetjes dhe kthimit në familje ose në vendin nga vjen dhe të sigurojë se ajo është në interes më të mirë të fëmijës.

8.Fëmijëve me nevoja të posaçme (çrregullim psiko-social, sëmundje ose shtatzëni, hendikepim) duhet t'u sigurohet ndihmë përkatëse.

9.Fëmijët viktimë kanë të drejtë të ndihmës shëndetësore, psiko-sociale dhe juridike dhe mbrojtjes i dhe të drejtë të arsimit.

10.Sigurim të mbrojtjes së papenguar shëndetësore të fëmijëve viktimë të tregëtisë me njerëz dhe krahas mosposedimit të sigurimit shëndetësor si dhe lehtësimit në lidhje me sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm mjekësor (certifikatë mjekësore).

Shteti duhet t'i intensifikojë aktivitetet në fushën e tregëtisë me njerëz në nivel nacional dhe të inkuadrohet në iniciativë rajonale të kësaj fushe. Duhet të përfshihen programe të caktuara për ndihmë juridike (pa pagesë dhe të arritshme) për viktimat e tregëtisë me njerëz nga ana e shtetit.

LIGJI I MBROJTJES SOCIALE

Me Ligjin e mbrojtjes sociale rregullohen forma konkrete të mbrojtjes, kur fëmija nuk ka kushte për jetë në familjen e tij.

Qendra për punë sociale vendos për mbrojtje jashtinstitucionale dhe institucionale, zbaton punë profesionale dhe ndërmer masa konkrete, varësisht nga moshë dhe nevojat e çdo fëmije.

Mbrojtja institucionale (neni 23):

1. Shtëpia e fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore "11 Tetori" - Shkup, ku vendosen fëmijët e moshës prej tre vjetësh deri në aftësimin e tyre për jetë të pavarur, ndërsa më së shumti deri gjashtë muaj pas përfundimit të shkollimit të mesëm.

2. Në shtëpinë e fëmijëve në gji dhe fëmijëve të vegjël në Manastir vendosen fëmijët e porsalindur deri në moshën trevjeçare, si dhe grua shtatzënë/nënë adoleshente një muaj para adoptimit ose tre muaj pas lindjes.

2. SOS fshati i fëmijëve - institucion privat për përkujdesjen e fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore.

Në nenin 34 të Ligjit të mbrojtjes sociale në mënyrë taksative janë përmendur kushtet që realizojnë të drejtën e ndihmës sociale:

- ndihmë e vazhdueshme në të holla për personat e paafte për punë dhe të pasiguruar social;
- ndihmë sociale në të holla për personat e afte për punë dhe të pasiguruar social;
- kompensim në të holla për ndihmë dhe përkujdesje;
- të drejtë të mbrojtjes shëndetësore;
- kompensim të rrogës për orar të shkurtër të punës për shkak të përkujdesjes së fëmijës me pengesa trupore ose intelektuale;
- ndihmë afatshkurtër në të holla ose ndihmë në natyrë;
- të drejtë të vendosjes në vendbanim;
- ndihmë në të holla të personave të cilët deri në moshën 18-vjeçare kanë pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore.

Të drejtë të ndihmës së vazhdueshme në të holla ka personi i paafte për punë dhe i pasiguruar social, i cili nuk mund të sigurojë mjete për ekzistencën e tij në bazë të rregullave të tjera.

Fëmijët pa prindër dhe përkujdesje prindërore, në pajtim me Ligjin e mbrojtjes sociale mund të realizojnë ndihmë të vazhdueshme në të holla (neni 34 paragrafi 5) i mbrojtjes sociale (neni 45) nëse të hollat në fjalë nuk i marrin në bazë tjetër. Qendra për punë sociale, në pajtim me Ligjin e mbrojtjes së fëmijëve vendos për të drejtat e shtesave fëmijërore, shtesë e veçantë dhe ndihmë për pajisje të fëmijës së porsalindur.

Mbrojtja jashtinstitucionale përfshin:

1. Vendosje në familje për përkujdesje
2. Përkujdesje në qendër ditore.

VENDOSJA NË FAMILJE PËR PËRKUJDESJE (NENI 20 DHE 85-87)

E drejta e vendosjes në familje për përkujdesje, paraqet mbrojtje jashtinstitucionale e cila krahas shfrytëzuesve të tjerë i realizojnë edhe kategoritë vijuese të fëmijëve:

-fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindërore (prindërit e të cilit kanë vdekur ose pavarësisht nga shkaqet, nuk dëshirojnë ose nuk mund të kujdesen për fëmijën e tyre). Vendosja në familje për përkujdesje zgjat deri në moshën 18-vjeçare të fëmijës, por edhe pas kësaj moshe deri në aftësimin e tij për jetë të pavarur dhe punë të fëmijës, përkatësisht deri në përfundimin e shkollimit të mesëm. Fëmija vendoset në familje për përkujdesje nëse nuk ekzistojnë mundësi që përkujdesja dhe edukimi të sigurohet në mënyrë tjetër;

-fëmija me probleme edukative-sociale, përkatësisht fëmija i cili është lënë pas dore ose keqpërdorur nga prindërit e tij, kujdestari ose persona të tjerë të cilët janë të obliguar të kujdesen për të, përkatësisht fëmijë i cili për shkak të marrëdhënieve të këqija në familje nënshtrohet që të marrë shprehje dhe manifestime të këqija në sjellje. Në këtë kategori të fëmijëve bie edhe fëmija i cili rrjedh nga familja e pasiguruar, në të cilën prindërit nuk kanë mjete të mjaftueshme që të kujdesen për zhvillimin dhe arsimin e tij të drejtë;

-fëmijë me sjellje të prishur shoqërore, në kategorinë e të cilave bien fëmijët - adoleshentë doras të veprës penale të cilëve ju nevojitet ndihmë e posaçme në risocializim, edukatë dhe arsim;

-fëmijë me pengesa mesatare dhe të rënda në zhvillimin intelektual, i cili është udhëzuar në aftësimin për punë - aktivitet prodhues në institucion jashtë vendit të tij të jetesës dhe duhet ta braktisë familjen e tij. Të drejtë përkujdesjeje kanë edhe fëmijët me pengesa më të rënda në zhvillimin intelektual dhe person me pengesa më të rënda trupore të cilit i nevojitet përkujdesje përfundimtare, ndërsa familja e tij nuk është në gjendje të sigurojë përkujdesje për shëndetin e tij.

Në vitin 2004 janë nxjerrë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtje sociale (Neni 124-138) dhe në mënyrë normative përmirësohet ushtrimi i funksionit përkujdesës, ndërsa me qëllim që të krijohet motivimi më i madh i qytetarëve për përkujdesje të fëmijëve në familjen e tyre. Është dhënë mundësia që personi fizik profesionalisht të merret me funksionin përkujdesës si veprimtari e pavarur dhe të sigurojë stazh pune dhe bazë pensionale. Ligji synon që përkujdesësi të ketë së paku arsimin e mesëm dhe të ketë gjendje të mirë shëndetësore që të mund me sukses të kujdeset për fëmijët e vendosur. Përkujdesësi duhet të jetë person i aftë afarist, kundër të cilit nuk

është udhëhequr procedurë për mohimin e të drejtës prindërore në aspektin e fëmijëve të tij dhe të ketë hapësirë përkatëse dhe pajisje për punë.

Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me vendim lëshon leje për ushtrimin e veprimtarisë për përkujdesje të fëmijëve në familjen e personit që dëshiron të merret me këtë veprimtari. Qendra e Punës Sociale paraprkishtë jep mendim se a është qytetari i përshtatshëm dhe se a ka mundësi për përkujdesjen e fëmijëve. Pas marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë, përkujdesësi lidh Marrëveshje me Qendrën për punë sociale, në të cilën rregullohen edhe mënyra në të cilën personi do të kujdeset në familjen e tij.

Pritet që zgjidhja e kësaj ligjore do të nxitë qytetarët të cilët kanë të kryer arsimin e lartë përkatës nga profesionet e përshtatshme për ushtrimin e funksionit të përkujdesjes, si dhe në edukimin e fëmijës (pedagogji, psikologji etj.), të cilët për shkak se nuk janë të punësuar do të fillojnë të merren me funksionin e përkujdesjes si veprimtari e tyre profesionale. Në këtë mënyrë është krijuar mundësi që të angazhohen familjet përkujdesëse me potencial më të lartë për ushtrimin e funksionit përkujdesës, me çka do të ngrihet cilësia në këtë formë të mbrojtjes së fëmijëve.

Ligji jep mundësi që me përkujdesjen e fëmijëve të mund të merren edhe personat me lidhjen e Marrëveshjes me Qendrën për punë sociale. Me marrëveshjen rregullohet mënyra e vendosjes së fëmijës në familje përkujdesëse dhe kujdesi që duhet t'i sigurohet për plotësimin e nevojave të tij individuale, kushtet kur duhet të ndërpritet vendosja dhe kushte të tjera për ndërprerje të marrëveshjes. Familja përkujdesëse, në bazë të marrëveshjes së lidhur fiton kompensim për mbulimin e shpenzimeve për përkujdesje të fëmijës dhe kompensim për përkujdesësin për angazhimin e tij. Në Marrëveshjen e lidhur me Qendrën për punë sociale caktohet edhe vlera e kompensimit. Ministri i Punës dhe Politikës Sociale me Rregulloren do ta caktojë shumën e kompensimit për përkujdesjen dhe vendosjen veç e veç për çdo kategori të shfrytëzuesve të kësaj shërbimi.

Obligimet e përkujdesësit:

- Është i obliguar të veprojë sipas udhëzimeve të Qendrës për punë sociale për atë se si të kujdeset për fëmijën;

- Rregullisht ta informojë Qendrën për çdo ndryshim që do të ndodhë gjatë përkujdesjes së fëmijës, sjelljes së tij, edukimit, arsimit, shëndeti dhe të ngjashme.

Qendra e zgjedh familjen për përkujdesje në bazë të kriterëve vijuese: moshës së përkujdesësit, shkallës së arsimit të tij, përshtatshmërive të tija shëndetësore dhe morale, kushteve materiale dhe banesore të familjes dhe mundësisë së familjes për përkujdesjen e fëmijës.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kriteret për zgjedhjen e familjes për përkujdesje më për së afërmi do t'i përgatisë në Rregulloren me të cilën do të vërtetohet vlera e kompensimit për përkujdesjen dhe kompensimin për vendosjen e fëmijës në familjen për përkujdesje. Krahas kompensimeve për vendosje të fëmijës në familjen për përkujdesje, kjo realizon edhe të drejtën e shtesës fëmijërore, ndërsa nëse fëmija është me pengesa në zhvillim dhe shtesë të veçantë në pajtim me Ligjin për mbrojtje të fëmijëve. Me këto mjete mbulohen shpenzimet plotësuëse për fëmijën.

Me Rregulloren për familjet përkujdesëse, do të caktohet edhe lloji dhe numri i shfrytëzuesve që vendosen në një familje përkujdesëse dhe obligimet e përkujdesësit që i përkasin përkujdesjes dhe nevojave tjera të personit të vendosur. Rregullorja është përgatitur si propozim version dhe ende nuk është publikuar.

REKOMANDIME

1.Parashikimi i masave për zvogëlimin e varfërisë, përkatësisht garantimit dhe sigurimit të mjeteve minimale për ekzistencë të familjeve që kanë fëmijë adoleshentë, ndërsa të cilëve përmes punësimit ose në mënyrë tjetër nuk mund t'u sigurohet realizimi i mjeteve për ekzistencë, veçanërisht ndërmarrjes së masave sociale për familjet të të cilat janë identifikuar fëmijët - viktima të tregëtisë me njerëz, ose lloj tjetër i punës së dhunshme për shkak të gjendjes së rëndë sociale.

2.Parashikimi i sistemit përkatës për identifikim dhe regjistrim të fëmijëve në rrugë ose i fëmijëve të eksploatuar në punë dhe ndërmarrje të masave përkatëse për mbrojtjen e tyre me vendosjen në qendrat ditore dhe me ndihmën dhe edukatën e fëmijëve dhe të prindërve të tyre, si dhe me lidhjen e qendrave ditore me institucionet arsimore për përfshirjen e këtyre fëmijëve në arsimin e rregullt.

3.Masat që do të ndërmerren sipas kësaj kategorie fëmijë jashtë qendrës ditore (në familje, shkollë dhe para institucioneve tjera) të jenë nën mbikëqyrje të vazhdueshme të punëtorit social dhe psikologut të qendrës për punë sociale.

4.Krijimi i obligimit ligjor për formimin e strehimoreve për fëmijë - viktima të tregëtisë me njerëz, në të cilat strehimore duhet të angazhohen punëtorë sociale, psikologë dhe punëtorë shëndetësorë.

5.Në strehimore të angazhohen persona të besueshëm dhe me aftësim të posaçëm dhe vendndodhja e strehimores të jetë e njohur vetëm për rreth të caktuar të njerëzve, të cilët kanë obligim të ndërmarrin masa përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve.

6.Për çdo fëmijë të vendosur duhet të përgatitet program i veçantë me të cilin planifikohen masat të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen e fëmijës dhe si të realizohen ato. Ekipi profesional në program duhet të vërtetojë dinamikën e ndjekjes së rastit me vizita të rregullta të fëmijës në familjen që përkujdeset. Qendra është e obliguar të realizojë kontakte me shkollën që të ndjekë se si rrjedh procesi, me mjekun amë në aspektin e gjendjes shëndetësore të fëmijës dhe të ndërmerr masa tjera të

shëndetësore të fëmijës dhe të ndërmerr masa tjera të nevojshme që të ndjek se si zhvillohet dhe edukohet fëmija.

7. Kur të vërtetohet se përkujdesësi nuk kujdeset mirë për fëmijën ose se fëmija nuk ndjehet mirë në familjen që përkujdeset merret vendim për ndërrimin e familjes ose caktohet formë tjetër e mbrojtjes së fëmijës.

8. Që të fillohet ushtrimi profesional i individëve me funksionin e përkujdesësit, duhet të ndërmerren aktivitete për informim më të madh të qytetarëve, sensibilizimin dhe edukimin e tyre.

9. Duhet të zhvillohet bashkëpunim dhe përfshirja e të gjitha subjekteve në nivel lokal për ndihmë dhe përkrahje për familjet përkujdesëse.

10. Programet për edukim të specializuar të familjeve përkujdesëse për përkujdes të fëmijëve të cilëve iu nevojitet ndihmë dhe përkrahje e posaçme për risocializim (enti republikan për punë sociale, OJQ etj.).

11. Në raste të jashtëzakonshme - kur punohet me viktimë të tregtisë me njerëz, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me qendrat për punë sociale, mund të ndërmerr aktivitete të cilat nuk janë paraparë me ligj.

12. Statusi jolegal i viktimave të tregtisë me njerëz nuk duhet të jetë kriter refuzues për marrjen e mbrojtjes sociale.

13. Shtimi i nenit të ri në Ligjin e mbrojtjes sociale për sigurimin e mbrojtjes sociale të viktimave të tregtisë me njerëz dhe viktimave nga krim tjetër i organizuar transnacional.

14. Shtimi i nenit të ri në Ligjin e mbrojtjes sociale, për caktimin e mbrojtjes institucionale të viktimave të tregtisë me njerëz dhe viktimave nga krim tjetër i organizuar transnacional, me qëllim që të inkurajohen të dëshmojnë, të sigurohet siguria e tyre nga represionet e mundshme nga ana e tregtarëve dhe grupeve kriminale.

15. Në strehimore të fëmijëve të tregtuar duhet të sigurohet ndihmë përkatëse fizike, psiko-sociale, juridike, arsi-

more, vendosje, ndihmë sociale dhe shëndetësore, ku do të mbrohen nga eksploatimi i mëtejshëm.

16. Fëmijët viktimë të tregtisë, duhet të vendosen veç nga të moshuarit, duke pasur llogari për nevojat dhe të drejtat e tyre të posaçme.

17. Nxjerrja e Ligjit për personat me nevojë të veçanta, që do të përfshijë definicionin e unifikuar për personat e paafte, të hendikepuar dhe të sëmurë mendorë do të kenë të drejtë të mbrojtjes së posaçme të caktuar me këtë ligj.

18. Interesi më i mirë i fëmijës patjetër duhet të jetë obligim primar në të gjitha procedurat, pa dallim se a janë ndërmarrë nga organet shtetërore ose private apo institucionet.

19. Fëmijët viktimë të tregtisë me njerëz të mos jenë të përndjekur penalisht ose për kundërvajtje.

QENDRAT DITORE

Fëmijë në rrugë - fëmijë të rrugës. Me Programin e Ministrisë së Punës dhe

Politikës Sociale për mbrojtjen personave të përfshirë socialë ndërmerren masat e parapara dhe aktivitetet për mbrojtjen e fëmijëve të rrugës. Ky program është i drejtuar në evidencimin e të gjithë fëmijëve, ndërmarrjes së masave për punë me prindërit dhe ngritjes së shkallës së obligimit prindëror dhe përgjegjësisë, ndërsa në rast të evidentimit të fëmijëve të lënë pas dore inicim të procedurave për mohimin e të drejtës prindërore, vendosjes në Institucione të fëmijëve ose në familje për përkujdesje. Në rrjedhë janë aktivitetet për përforsim social të fëmijëve përmes përfshirjes në programe të qendrave ditore. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj forme të mbrojtjes të drejtuar në parandalimin e problemit të lënies pas dore dhe mosedukimit të fëmijëve.

TË DREJTAT E REJA

E drejta e strehimit. MPPS është në fazën e nxjerrjes së Rregullores me të cilën do të arrijnë të drejtën e strehimit të fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore të cilët kanë shfrytëzuar formë të mbrojtjes sociale, pas kalimit të moshës adoleshente, ndërsa më së voni deri në moshën 26-vjeçare.

Neni 49-50. Ndhimë e vazhdueshme në të holla të presonit i cili deri në moshën 18-vjeçare ka pasur statusin e fëmijës pa prindër dhe përkujdesje prindërore.

DELIKUENCA ADOLESHENTE

Qendra për punë sociale, në ushtrimin e ligjit autorizimin e besuar publik të organit kompetent për kujdestari, merr pjesë në procedurën para gjyqit për vërtetimin e përgjegjësisë, veprimit dhe caktimit të masave dhe dënimeve ndaj dorasëve adoleshentë të veprave penale.

Këto kompetenca të qendrës janë caktuar në rregullat penale juridike. Qendra për punë sociale, ushtron punë profesionale me adoleshentin dhe familjen e tij për vlerësimin e personalitetit të tij, zhvillimin e tij, edukatën, mjedisin dhe kushtet në të cilat jeton.

Qendra bashkëpunon me shkollën, avokatin pub-

lik, gjykatën dhe policinë për trajtim të mëtijshëm dhe risocializim të fëmijës.

Gjatë procedurës gjyqësore, Qendra jep propozim për caktimin e masës edukuese (qortim, mbikëqyrje të përforcuar nga prindi, familje tjetër dhe nga organi për kujdesje, dërgim në institucion edukativ dhe shtëpi edukative-përmirësuese), masë për sigurim ose me përjashtim burgim adoleshent.

Qendra për punë sociale e ndjek procesin e risocializimit të përgjithshëm të fëmijës në mjedisin familjar, aktivitetet e përditshme dhe sjelljes, përfshirë në arsim dhe edukatë, përmes përgatitjes së Programit për punë të çdo fëmije individualisht. Ky organ mund që gjykatës t'i propozojë ndërprerje ose vazhdim të masës, përkatësisht zëvendësim të një mase me masë tjetër. Në sistemin e mbrojtjes sociale ekziston Institucion për vendosje të fëmijëve dhe të rinjve me probleme edukative sociale dhe Institucion për fëmijë dhe të rinj me sjellje asociale.

Në Republikën e Maqedonisë në rrjedhë është përgatitja e ligjit të posaçëm për të drejta adoleshente. Në këtë rregull do të bëhet bashkimi i të gjitha dispozitave dhe procedurave të cilat i përkasin zbatimit të masave dhe sanksioneve për dorasit adoleshent të veprave penale. Risetë që priten me nxjerrjes e kësaj rregulloreje është sjellja e punës parandaluese me fëmijët adoleshentë nga moshë 7 deri 14 vjeçare. Fëmijët në këtë moshë që kanë bërë vepër penale ose shkelje konsiderohen si fëmijë në rrezik. Si fëmijë në rrezik kon-

siderohet fëmija i varur nga drogat ose alkooli, fëmijë me pengesa më të rënda trupore ose në zhvillim intelektual, fëmijë i cili është lënë pas dore në edukatë ose zhvillim social, përkatësisht familja e tij nuk mund ta realizojë funksionin edukativ, fëmijë që nuk shkon në shkollë ose që i është dhënë lëmshës, bredhjes ose prostitucionit dhe për shkak të gjendjes së këtyre mund ose ka ardhur në kundërshtim me ligjin.

Puna parandaluese me këto fëmijë është drejtuar në ndërmarrjen e masave me ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijës. Masat i zbaton Qendra për punë sociale, përmes Programit në të cilin do të parashihet puna me fëmijën, prindërit e tij, kujdestarin ose familjen që përkujdeset. Parandalimi me fëmijë të kësaj moshe, ndërsa që kanë paraqitur sjellje asociale është e rëndësishme për trajtim të shpejtë me fëmijët dhe edukimin dhe riedukimin e tyre të drejtë. Në këtë mënyrë pritet që fëmijët të mbrohen që të mos paraqesin sjellje delikuede në zhvillimin e tij të mëtijshëm.

Për shkak të zbatimit të parandalimit të delikuecës adoleshente, teksti i punuar i Ligjit për drejtësi adoleshente parasheh formimin e Këshillit shtetëror dhe këshillit komunal për parandalim. Këshilli shtetëror parashihet të jetë i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Politikës Sociale, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit gjyqësor, Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë, Avokatit publik të Republikës së Maqedonisë dhe Avokatit të popullit. Këshillat komunalë formohen për shkak të zbatimit të parandalimit në nivel lokal.

LIGJI I MBROJTJES SË FËMIJËVE

Fëmijës në Republikën e Maqedonisë kanë të drejta më të mëdha që janë të mbrojtura me konventat dhe aktet ndërkombëtare, si dhe me ligjet e vendit, rregullore dhe akte. Republika e Maqedonisë është nënshkruese dhe i zbaton të gjitha këto akte ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen dhe parandalimin nga dhuna, torturat, diskriminimi që është i inkorporuar edhe në legjislativin e vendit.

Në nenin 40 paragrafi 4 të Kushtetutës së RM-së thuhet:

Republika iu siguron mbrojtje të veçantë fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në nenin 1 të Konventës për të drejtat e fëmijës thuhet se, për qëllimet e kësaj konvente, fëmijë është çdo krijesë njerëzore që nuk ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet, nëse në bazë të ligjit që i përket fëmijës, moshë madhore nuk arrihet më herët.

Në nenin 3 (d) të Protokollit për parandalim, shkatërrim dhe dënim të tregtisë me njerëz, veçanërisht gra dhe fëmijë, me të cilin plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional, qëndron se, fjala fëmijë do të thotë çdo person që është në moshën nën tetëmbëdhjetë vjet.

Në nenin 2 të Konventës së organizatës ndërkombëtare të punës që i përket ndalimit dhe aksionit urgjent për eliminimin e llojeve më të këqija të eksploatimit të fëmijëve të punës fjala fëmijë do të përdoret për të gjithë personat nën moshën 18-vjeçare.

Në legjislacionin tonë, në nenin 8 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve thuhet se, si fëmijë në kuptimin e këtij ligji konsiderohet çdo person deri në mbushjen e 18-vjetëve të jetës, si dhe person me zhvillimin fizik dhe psikik deri në mbushjen e 26 vjetëve të jetës.

Në lidhje me përgjegjësinë penale në KL të RM thuhet se fëmija është personi deri në mbushen e 14v. të jetës, ndërsa nga 14-16v. është adoleshent më i ri, ndërsa nga 16-18v. është adoleshent më i rritur.

Sa i përket definimit të personave të hendikepuar dhe të sëmurë mendorë nuk ka definicion universal. Në më tepër ligje ka definicione të ndryshme, ndërsa para së gjithash nga këtu paraqitet nevoja për nxjerrjen e ligjit të veçantë.

Në nenin 9 paragrafi 1 i Ligjit të mbrojtjes së fëmijëve, ndalohet keqtrajtimi psikik dhe fizik, dënimi ose veprim tjetër jonjerëzor ose keqpërdorim i fëmijëve.

Në nenin 3 (a) të Protokollit për parandalim, shkatërrim ose dënim të tregtisë me persona, veçanërisht gra dhe fëmijë, me të cilin plotësohet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional definohet fjala tregti me njerëz, sipas së cilës fjalë tregtia me njerëz do të thotë rekrutim, bartje, strehim ose pranim të personave, përmes kërcënimit ose me përdorimin e forcës formave të tjera të dhunës, ose kidnapimit, ose mashtrimit, ose gënjimit, ose me keqpërdorim të forcës ose të gjendjes së pafuqisë ose me dhënie ose pranim të të hollave në dobi për arritjen e pëlqimit të personit që ka kontrollin ndaj personit tjetër, me qëllim të eksploatimit. Eksploatimi nënkupton, në masë më të vogël, eksploatimin e prostitucionit të personave tjerë ose formave tjera të eksploatimit seksual, punës së dhunshme ose shërbimit të dhunshëm, robërisë ose veprimit të ngjashëm me robërinë, shërbimit ose nxjerrjes së organeve.

Në nenin e njëjtë në pikën (c) thuhet se rekrutimi, transportimi, bartja, strehimi ose pranimi i fëmijës për eksploatim do të konsiderohet për tregti me njerëz edhe atëherë kur nuk është përfshirë përdorimi i ndonjë mënyre të caktuar në pikën (a) të këtij neni.

*Në Ciceronin e UNICEF-it për mbrojtjen e fëmijëve vik-
tima të tregtisë në Evropën Juglindore, tregtia me
fëmijë është akt i rekrutimit, transportimit, zhven-
dosjes, ruajtjes dhe pranimi të fëmijëve me qëllim të
eksploatimit të tyre në vend ose jashtë. Pajtimi i
fëmijëve viktima për eksploatimin e dedikuar është
jorelevante, edhe në rast se nuk është shfrytëzuar
asnjë nga mjetet vijuese: forcë, dhunë, kidnapim,
mashtrim, keqpërdorim të forcës ose aktivitete të
ndërmarrja derisa fëmija gjendet në gjendje të prek-
shme ose derisa është në kontrollin e personit tjetër.*

INë nenin 11 të Kushtetutës së RM-së caktohet se integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të përvokueshme. Ndalohet çdo formë e mundimit, sjelljes jonjerëzore dhe poshtëruese dhe dënimit. Gjithashtu ndalohet puna e dhunshme.

REKOMANDIME

1.Parashikimi i masave të posaçme për përfshirjen e fëmijëve - viktimë të tregëtisë ose lloj tjetër të punës së dhunshme në institucionet arsimore dhe për rehabilitimin dhe risocializimin e tyre.

2.Fëmijës - viktimë patjetër duhet t'i sigurohet ndihmë e përkohshme juridike dhe informacione lidhur me statusin e tij, për gjendjen në të cilën gjendet, si dhe për të drejtat dhe obligimet që i ka sipas legjislacionit tonë.

3.Nëse moshë e fëmijës nuk dihet me siguri, derisa zgjat verifikimi i moshës së viktimës, ajo duhet të trajtohet si fëmijë, dhe duhet t'i sigurohen të gjitha masat e nevojshme të mbrojtjes.

4.Menjëherë pas identifikimeve të para fëmijët viktimë duhet të vendosen në lokacion të sigurtë (strehimore, shtëpi, familje ose institucion tjetër).

5.Qendrat për punë sociale në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të zhvillojnë standarde për ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes në vendet ku janë vendosur fëmijët viktimë.

6.Në lidhje me kujdesin dhe ndihmën duhet të kihet parasysh prejardhja, gjinia, moshë dhe se si fëmijë-viktimë a paraqitet me nevojë të posaçme (pengesa psiko-sociale, hendikepim, sëmundje ose shtatzëni).

7.Nxjerrje e programeve të veçanta për mbrojtje dhe përkrahje të fëmijëve viktimë të tregëtisë në lidhje me ndihmën e tyre fizike, psikologjike, juridike, arsimore shëndetësore dhe vendosje.

8.Ndërmarrja e masave për mbrojtje private dhe të identitetit të fëmijës - viktimë.

LLIGJI I QASJES SË LIRË NË INFORMACIONET E KARAKTERIT PUBLIK

Me këtë ligj rregullohen kushtet, mënyra dhe procedura e realizimit të së drejtës së qasjes së lirë në informacionet e karakterit publik me të cilat disponojnë organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet tjera të caktuara me ligj. Me ligjin të gjithë personave fizikë dhe juridikë iu mundësohet të realizojnë të drejtën e qasjes së lirë në informacionet e karakterit publik, ndërsa poseduesit e informacioneve janë të obliguar të sigurojnë punë të hapur dhe publike. Qasje të lirë në informacione kanë edhe personat e huaj juridikë dhe fizikë.

Posedues të informacioneve janë organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet tjera të caktuara me ligj, organet e komunës, të qytetit të Shkupit, institucionet publike dhe shërbimet, ndërmarrjet publike dhe personat juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë autorizime dhe veprimtari publike të interesit publik të caktuar me ligj.

Në nenin 5 të ligjit në mënyrë decide janë shënuar kushtet kur poseduesi i informacionit mund të refuzojë kërkesën për qasje në informacion. Informacioni nuk do të jepet nëse ai i përket:

1. informacionit i cili në bazë të ligjit paraqet informacion të klasifikuar me shkallë sekrete përkatëse;
2. e dhënë personale zbulimi i së cilës do të thotë prekje të mbrojtjes së të dhënave personale;
3. informacion për punë arkivuese që është e caktuar si e besueshme;
4. informacion i cili me dhënien e tij do të thotë prekje e besueshmërisë së procedurës tatimore;
5. informacion që është arritur ose përbërë për hetim, procedurë penale ose kundërvajtëse, për zbatimin e procedurës administruese dhe qytetare, e dhënë kohë që do të kishte pasoja të dëmshme gjatë procedurës;
6. informacioni i cili i përket interesave komerciale ose interesave tjera ekonomike, përfshirë edhe interesat e politikës monetare dhe fiskale, e dhënë kjo që do të kishte pasoja të dëmshme në realizimin e funksionit;
7. informacion nga dokument që është në procedurë të përgatitjes dhe që edhe është lëndë e pëlqimit të poseduesit të informacioneve, zbulimi i të cilës do të shkaktonte kuptim të gabuar të përmbajtjes;
8. informacion për mbrojtjen e mjedisit jetësor që nuk është i arritshëm për opinionin për shkak të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor; dhe
9. informacion që i rrezikon të drejtat e pronës industriale ose intelektuale (patentë, model, mostër, vulë mallrash dhe shërbyese, shenja e prejardhjes së prodhimit).

Poseduesit e informacioneve janë të obliguar që ta informojnë opinionin për:

-të dhënat bazë për kontakt me poseduesin e informacionit edhe atë: emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa dhe adresa e veb faqes;

-shkresa që i përkasin kompetencave të poseduesit të informacioneve, lidhur me regjistrin për shkresat të publikuar në gazetën zyrtare;

-propozim programet, programet, strategjitë, qëndrimet, mendimet, studimet etj. dokumente të ngjashme të cilat i përkasin kompetencave të poseduesit të informacioneve;

-të gjitha thirrjet në procedurën për furnizimet publike dhe dokumentacionin e tenderit të caktuar me ligj;

-të dhëna për kompetencat e saja të caktuara me ligj;

-organizimin dhe shpenzimet gjatë punës, si dhe dhënie të shërbimeve të qyte tarëve në procedurën administruese dhe për të gjitha aktivitetet e saja;

-botimi i buletineve informative dhe formave të tjera të informimit;

-internet faqen për publikimin e vendimeve, masave dhe akteve me të cilat ndikohet në jetën dhe punën e qytetarëve;

-informacione të tjera të cilat dalin nga kompetencat dhe puna e poseduesit të informacioneve.

Për poseduesin e informacioneve janë paraparë dënime nëse në kundërshtim me nenin 6 lejohet qasje në informacionin në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, nëse për këtë arsye është bërë dëm për kërkuesin, për opinionin ose interesin që mbrohet me këtë informacion.

Qendrat për punë sociale si posedues të informacioneve - disponojnë me të dhëna të cilat i përkasin viktimave konkrete të tregtisë me njerëz. Personat përgjegjës në qendrat për punë sociale duhet të sigurojnë qasje të lirë në informacionet e kërkuesit të caktuar të informacionit - zyra e MNU, OJQ dhe institucione tjera të cilat punojnë me viktimat e tregtisë me njerëz.

Gjithashtu qendrat për punë sociale kërkuesit të caktuar në pajtim me këtë ligj kanë të drejtë të refuzojnë të japin informacione nëse konsiderojnë se me dhënien e informacionet mund të rrezikohet siguria e personit të caktuar ose se informacioni i kërkuar paraqet prekje të mbrojtjes së të dhënave personale. Qendrat për punë sociale kanë të drejtë të refuzojnë të japin dëshmi në lidhje me informacionet të cilat kanë qenë të besueshme nga ana e viktimave të tregtisë me njerëz gjatë detyrave të tyre


profesionale nëse me dhënien e informacioneve të tilla bëhet prekje e mbrojtjes së të dhënave personale. Në mënyrë të veçantë është e rëndësishme mbrojtja e të dhënave personale në lidhje me mediat. Rastet e tregtisë me njerëz shkaktojnë interes të madh të mediat, kjo rritë nevojën për kujdes të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave. Fotografia dhe historia e tij personale nuk duhet t'u jepet mediave, por as edhe detajet me të cilat mund të vjen deri te identifikimi i viktimës, siç është adresa e tij.

Për personin përgjegjës të poseduesit të informacioneve janë paraparë edhe dënime në të holla, nëse në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji do të jep të dhëna për informacion, që nuk duhet të jepet, ndërsa gjithashtu do të dënohet dhe nëse refuzon të jep informacion, ndërsa për këtë arsye është bërë dëm për kërkuesin, për opinionin ose interesin që mbrohet me këtë informacion.

Sipas nenit 38 të këtij ligji lirohet nga përgjegjësia i punësuari në administratën shtetërore që do të jep informacion mbrojtës, nëse ajo është e rëndësishme për zbulimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe sjelljes korruptive, si dhe ndalimin e kërcënimeve serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe rrezikimit të mjedisit jetësor.

Qëllimi kryesor i këtij ligji është që qytetarëve t'u mundësohet qasje përkatëse në informacione që të mund të mund të paraqesin qëndrimin dhe mendimin e tyre kritik për punën e pushtetit publik. Me këtë ligj zvogëlohet mundësia për spekulime sepse informacionet do të merren drejtpërdrejt nga poseduesit e informacioneve. Gjithashtu, me këtë ligj qytetarët do të nxiten dhe inkurajohen ta shfrytëzojnë këtë të drejtë.

Ligji i qasjes së lirë në informacionet e karakterit publik do të zbatohet nga 1 shtatori i vitit 2016. Deri në këtë periudhë duhet të nxirren edhe akte nënligjore, statute rregullore për punë të komisionit, rregullore dhe udhëzime në çfarë mënyre duhet të veprohet me kërkesën e qytetarëve.



**Analizë në bazë të të dhënave për viktimat
potenciale të tregëtisë me njerëz**

Tregtia me njerëz është keqpërdorim i të drejtave njerëzore të viktimës. Mbrojtja e të drejtave të personave të cilat janë lëndë të tregëtisë me njerëz duhet të jenë përparësi të të gjitha masave për luftë kundër tregëtisë me njerëz. Edhe krahas masave të shumta për mbrojtjen e të drejtave njerëzore, deklaratave dhe marrëveshjeve në praktikë, mjeteve për ballafaqim me tregtinë me njerëz i shkelin parimet e të drejtave njerëzore. Mekanizmi për mbrojtje duhet të përfshijë qark të gjerë të shërbimeve të ndryshme të specializuara, të cilat fokusohen në nevojat konkrete të çdo individi.

Për ballafaqim më të suksesshëm të fenomenit të tregëtisë me njerëz ende ekziston hapësirë për përmirësimin e rregullativës ligjore për mbrojtjen e viktimave. Duhet të zbatohen reforma juridike të cilat i përkasin përmirësimit të legjislaturës për luftë kundër tregëtisë me njerëz nga aspekti i të drejtave njerëzore të viktimave. Për mekanizëm funksional të udhëzimit të viktimave - MNU, duhet të bëjë plotësime dhe ndryshime në rregullativën e analizuar ligjore përkatësisht në ligjin penal, procedurën penale, ligjin e familjes, ligjin e mbrojtjes sociale, ligjin e mbrojtjes së fëmijëve. Me rëndësi të veçantë në sigurimin e ndihmës së viktimave të tregëtisë me njerëz dot të ishte bashkëpunimi me grupet qytetare ose organizatat joqeveritare të vendit të cilat janë inkuadruar në zgjidhjen e problemeve të tregëtisë me njerëz, ose me mbrojtjen e viktimave, siç janë grupet e femrave, OJQ-të të cilat merren me të drejtat njerëzore, dhunën ndaj grave, si dhe grupet për barazi gjinore.

Analiza e bazës të të dhënave për viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz

Mekanizmi Kombëtar për Udhëzim disponon me bazën e të dhënave të viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz me prejardhje nga vendi. Në bazë të këtyre të dhënave është përpunuar fenome-

nologji e viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz nga vendi. Fotografia është krijuar si rezultat i pyetësorit të gjysëmstrukturuar prej 26 pyetjeve të plotësuar nga ana e punëtorëve socialë të nominuar të cilët punojnë në fushën e tregëtisë me njerëz në kuadër të Qendrave për punë sociale në Republikën e Maqedonisë. Analiza hap pyetje të cilat e përbëjnë gjenezën e viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz nga vendi.

Ajo është paraqitur në 2 nivele

A. Mikro nivel- Personi viktimë potenciale e tregëtisë me njerëz


B. Mezo nivel- Rrethina e ngushtë(familja) dhe e gjerë(miçë, shokë-qe)

● Me shqyrtim të veçantë të vendosjes institucionale të Mekanizmit Kombëtar për Udhëzim-mjete për përvetësim dhe mrojtje të viktimave të tregëtisë me njerëz.

Të dhënat janë mbledhur nga 1 janari 2006 deri në 1 dhjetor 2006 dhe janë përpunuar në periudhën prej shtatorit, tetor dhe nëntor të vitit 2006.


Viktimë potenciale e tregëtisë me njerëz i identifikuar është personi i cili i plotëson tre elementet e tregëtisë me njerëz (PROÇES- regrutim, transport, transfer, fshehje, pranim MJETE-kërcënim, detyrim, rrëmbim, gënjeshërë, gënjeshtrim, përdorim i dhunës QËLLIM-prostitucion, pornografi, shfrytëzim seksual, punë e detyruar, robërim) dhe ka një ose më shumë nënelemente janë lindur në Maqedoni ose janë shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Shpërndarja moshatare e viktimës potenciale të tregëtisë me njerëz e identifikuar me prejardhje nga vendi (burim MKU 2006)




2. Arsimit

Shkalla e arsimit të viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz të identifikuar me prejardhje nga vendi (burim MKU 2006)




3. Inkuadrimi arsimor (inkluzion)




4. Përkatësia kombëtare, e viktimave potenciale të tregëtuar burim MKU 2006

Përkatësia kombëtare, e viktimave potenciale të tregëtuar burim MKU 2006




5. Gjendja civile

Gjendja civile e viktimave potencilë të tregëtisë me njerëz (burim MKU 2006)




6. Viktima dhe pasardhësit

A ka fëmije vikima (burim MKU)




7. Dokument për identifikim

identifikim




8. Burim të ardhurash

ardhurash



9. Gjendja shëndetësore

gjendja



Përfundime

Tek të dhënat e përpunuara të viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz dominant është grupi i moshës prej 15 deri në 18 vjet, 44% po ashtu mund të vërehet se është e lartë përqindja prej 20% të fëmijëve prej 10 deri në 14 vjetë.



Analoge me moshën është edhe arsimit tyre, 40% me arsim tetëvjeçar të plotë, 36% me tetëvjeçar jo të plotë, dhe 16% nuk kanë asnjë lloj arsimit, shqetësues është edhe fakti se 98% nuk ndjekin asnjë lloj mësimi.



Sipas përkatësisë kombëtare mund të vërehet se 52% janë të kombësisë maqedonase, 28% romë, 16% shqiptare, dhe 4% të kombësisë turke.



Përqindja më e madhe e viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz janë të pamartuar dhe 71% prej tyre nuk kanë fëmijë.



Në kontaktin e parë në QPS 61% të viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz nuk kanë patur dokumenta identifikimi.




Në lidhje me burimet e të ardhurave 55% nuk kanë patur asnjë burim të ardhurash dhe 25% fitojnë ndihmë sociale.


B. Mezo Nivel

Rethana e gjerë dhe fenomenologjia e viktimës potenciale të tregëtisë me njerëz e identifikuar me prejardhje nga vendi

1. Funkionimi familjar




2. Tip i familjes disfunktionale




3. Kontakte sociale dhe tregëtia

3a




3b




4. Fenomenologjia e viktimës potenciale e identifikuar me prejardhje nga vendi

Proçes Mjete Qëllim





Explanation

Transport Pranim Mashttrim Përgënjeshttrim Gënjim Kërcënim
Pornografi Shfrytëzim seksual Detyrim Punë Robëri Lypje



5. Përkushtimi institucional i MKU - preventim dhe mrojtje

5a



Përfundime

Viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz rreth 91% e kanë prejardhin nga familje disfunktionale the këto:

- 32% nga familje me marrëdhënie familjare të prishura
- 21% me një prindër të vdekur
- 21% me prindër të divorcuar
- 11% me prindër të ndarë

Sa i përket kontakteve sociale të cilat i realizojnë viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz mund të vërehet se 95% mbajnë kontakte me familjarët e afërt por në lidhje të kontakteve me shokë/qe kjo përqindje dukshëm është më e vogël dhe 55% nuk kanë kurfarë kontaktesh me miqë/ke shokë/qe.

Për erozimin e familjes vlet fakti se 40% të familjeve kanë ndermjetësuar në procesin e tregëtisë. Si ndërmjetës praqiten shokë/qe 18% po kaq është edhe përqindja e personave të panjohur dhe miqë/ke janë 14%.

Në procesin e identifikimit të viktimave potenciale të tregëtisë me njerëz mund të vërehen përqindjet e procesit si më poshtë, mjete dhe qëllim:

- 17% transport, 4% pranim
- 17% Mashtrim, 14% përgënjeshtim, 6% detyrim dhe nga 2% gënjim dhe kërcënim
- 10% prostitucion, 14% shfrytëzim seksual, 6% punë e detyruar dhe 8% lypje,
- 70% nga viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz të identifikuar vulneraristë kanë kon taktuar me tregëtarin.

Në QPS shpeshherë viktimat potenciale të tregëtisë me njerëz për të kërkuar ndihmë janë udhëzuar nga policia, anëtar të familjes, nga zyra e MKU dhe nga OJQ.

Në QPS si shërbim shpesh herë i është dhënë ndihmë psikosociale 49%, të udhëzuar në strehim përmes zyrës së MKU 43%, ndihmë të njëfishtë financiare 4% dhe ndihmë juridike 4%.



**Pjesë nga raporti për evaluim
(periudha shtator 2005 - korrik 2006)**

PJESË NGA RAPORTI PËR EVALUIM Periudha: shtator 2005 - korrik 2006

Qëllimi i raportit

Raporti për evaluim i mbledh të gjitha konkluzat kyçe dhe parapëlqimet nga vlerësimi i bërë nga konsultuesi për Zyren koordinuese të Mekanizmit Kombëtar për Udhëzime (MKU) dhe për aktivitetet në kuadër të projektit MKU. Gjatë përgatitjes së raportit dhe realizimit të vlerësimit, konsultuesi i merr parasysh të gjitha dokumentet relevante projektuese, përfshirë edhe përshkrimin e projektit dhe të gjitha materialet e shkruara të cilat janë miratuar si rezultat i projektit. Si plotësim i kësaj, konsultuesi njihet me aktivitetet e kaluara të Zyres së MKU-së përmes raporteve paraprake dhe publikimeve të botuara nga dhe për organizatën.

Qëllimi kryesor i raportit ishte që të zbatojë vlerësimin e projektit MKU, me qëllim që të identifikohen të gjitha mundësitë për zhvillim dhe implementim të projektit, si dhe të përmirësohen kapacitetet e personelit të MKU-së për implementimin e projektit të suksesshëm, profesional dhe të qëndrueshëm që ka për qëllim t'i përkushtohet një nevojë urgjente humanitare dhe publike.

Në plotësim të kësaj, raporti e vlerësoi nivelin deri ku qëllimet ekzistuese të projektit janë hasur në mënyrë efikase dhe efektive, dhe ta vërtetojë ndikimin e projektit. Kriteret specifike për evaluim të cilat u morën parasysh ishin:

Relevanca - *niveli deri ku qëllimet e projektit kanë qenë përkatëse me problemin me të cilin projekti MKU duhej të ballafaqohej;*

Efikasiteti - *a janë realizuar me mençuri rezultatet;*

Efektiviteti - *niveli deri ku grupi qëllimor ka pasur dobi nga shërbimet;*

Ndikimi - *niveli deri ku projekti ka kontribuar në realizimin e qëllimeve të politikave dhe programeve më të gjera për luftë kundër tregëtisë me njerëz.*

Përgatitja e raportit ka ndjekur kornizën e caktuar paraprake, dhe pas përfundimit të periudhave për përgatitje dhe vlerësim, i njëjti u finalizua në shtator të

vitit 2006. Periudha për vlerësim u realizua përmes hulumtimit me përdorim të pyetësorëve, intervistave të strukturuar specifike, mbledhjeve me grupe fokusuese dhe mbikqyrjes së drejtpërdrejtë.

Konsultuesja, znj. Sunçica Dimitrijoska, është profesoreshë e Fakultetit filozofik në Shkup - Instituti për punë dhe politikë sociale. Ajo ka përvojë praktike në fushën e punës sociale dhe përvojë më të gjerë me hulumtimet sociale. Ky dokument prezanton pjesë nga raporti për evaluim i cili i përmban konstatim komplet të konsultuesit.



Konstatimet specifike për kompatibilitetin e projektit me përparësitë, për pjesëmarrjen dhe për nivelet informuese

Ekziston nivel i lartë i kompatibilitetit ndërmjet përparësive të Republikës së Maqedonisë dhe projektit të implementuar me përkrahje të OSBE-së. 99 % nga personat e marrë në pyetje janë shprehur se kanë ndjerë nevojën për një projekt të këtillë dhe se projekti në fjalë është përparësi për to, ndërsa 1 % kanë konsideruar se nuk ka nevojë për një projekt të këtillë.

Nivelet e plotësimit, janë gjithë të larta: 98 % nga personat e pyetur janë shumë të kënaqur nga efektet e projektit, ndërsa 2 % janë të pakënaqur nga implementimi i projektit MKU.

Shembull: Në Komunën e Shën Nikollës, një nga punëtorët socialë të inkuadruar në grupin fokusues tha se projekti i NRM është ngjarje e madhe për Qendrën për Punë Sociale (QPS) për shkak se aktivitetet e mëparshme të qendrës kanë qenë të sjella në detyra administrative, pa zbatim të çfarëdo aktivitetesh socio-terapeutike të cilat e përbëjnë bazën e punës sociale.

Pjesëmarrja e partnerëve në aktivitetet projektuese është në nivel plotësues. Në të gjitha komunat ku janë identifikuar viktimat e supozuara, QPS kanë qenë të përfshira pa kurrfarë kompensimi plotësues financiar.

Qëllimi i raportit

Raporti për evaluim i mbledh të gjitha konkluzat kyçe dhe parapëlqimet nga vlerësimi i bërë nga konsultuesi për Zyren koordinuese të Mekanizmit Kombëtar për Udhëzime (MKU) dhe për aktivitetet në kuadër të projektit MKU. Gjatë përgatitjes së raportit dhe realizimit të vlerësimit, konsultuesi i merr parasysh të gjitha dokumentet relevante projektuese, përfshirë edhe përshkrimin e projektit dhe të gjitha materialet e shkruara të cilat janë miratuar si rezultat i projektit. Si plotësim i kësaj, konsultuesi njihet me aktivitetet e kaluara të Zyres së MKU-së përmes raporteve paraprake dhe publikimeve të botuara nga dhe për organizatën.

Qëllimi kryesor i raportit ishte që të zbatojë vlerësimin e projektit MKU, me qëllim që të identifikohen të gjitha mundësitë për zhvillim dhe implementim të projektit, si dhe të përmirësohen kapacitetet e personelit të MKU-së për implementimin e projektit të suksesshëm, profesional dhe të qëndrueshëm që ka për qëllim t'i përkushtohet një nevojë urgjente humanitare dhe publike.

Në plotësim të kësaj, raporti e vlerësoi nivelin deri ku qëllimet ekzistuese të projektit janë hasur në mënyrë efikase dhe efektive, dhe ta vërtetojë ndikimin e projektit. Kriteret specifike për evaluim të cilat u morën parasysh ishin:

Relevanca - *niveli deri ku qëllimet e projektit kanë qenë përkatëse me problemin me të cilin projekti MKU duhej të ballafaqohej;*

Efikasiteti - *a janë realizuar me mençuri rezultatet;*

Efektiviteti - *niveli deri ku grupi qëllimor ka pasur dobi nga shërbimet;*

Ndikimi - *niveli deri ku projekti ka kontribuar në realizimin e qëllimeve të politikave dhe programeve më të gjera për luftë kundër tregtisë me njerëz.*

Përgatitja e raportit ka ndjekur kornizën e caktuar paraprake, dhe pas përfundimit të periudhave për përgatitje dhe vlerësim, i njëjti u finalizua në shtator të

vitit 2006. Periudha për vlerësim u realizua përmes hulumtimit me përdorim të pyetësorëve, intervistave të strukturuar specifike, mbledhjeve me grupe fokusuese dhe mbikqyrjes së drejtpërdrejtë.

Konsultuesja, znj. Sunçica Dimitrijoska, është profesoreshë e Fakultetit filozofik në Shkup - Instituti për punë dhe politikë sociale. Ajo ka përvojë praktike në fushën e punës sociale dhe përvojë më të gjerë me hulumtimet sociale. Ky dokument prezanton pjesë nga raporti për evaluim i cili i përmban konstatim komplet të konsultuesit.



Konstatimet specifike për kompatibilitetin e projektit me përparësitë, për pjesëmarrjen dhe për nivelet informuese

Ekziston nivel i lartë i kompatibilitetit ndërmjet përparësive të Republikës së Maqedonisë dhe projektit të implementuar me përkrahje të OSBE-së. 99 % nga personat e marrë në pyetje janë shprehur se kanë ndjerë nevojën për një projekt të këtillë dhe se projekti në fjalë është përparësi për to, ndërsa 1 % kanë konsideruar se nuk ka nevojë për një projekt të këtillë.

Nivelet e plotësimit, janë gjithë të larta: 98 % nga personat e pyetur janë shumë të kënaqur nga efektet e projektit, ndërsa 2 % janë të pakënaqur nga implementimi i projektit MKU.

Shembull: Në Komunën e Shën Nikollës, një nga punëtorët socialë të inkuadruar në grupin fokusues tha se projekti i NRM është ngjarje e madhe për Qendrën për Punë Sociale (QPS) për shkak se aktivitetet e mëparshme të qendrës kanë qenë të sjella në detyra administrative, pa zbatim të çfarëdo aktiviteteve socio-terapeutike të cilat e përbëjnë bazën e punës sociale.

Pjesëmarrja e partnerëve në aktivitetet projektuese është në nivel plotësues. Në të gjitha komunat ku janë identifikuar viktimat e supozuara, QPS kanë qenë të përfshira pa kurrfarë kompensimi plotësues financiar.

het. Besueshmëria e të dhënave personale duhet të respektohet dhe plotësisht të avancohet;

-Vullnetarë të rinjë ose punëtorë socialë të kontraktuar duhet të huazohen, me qëllim që të arrihet kontribut më i gjerë ndaj shoqërisë;

-Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve ndërmjet personave lokalë dhe nacionalë në nivel qendror duhet në mënyrë plotësuese të avancohet;

-Si rezultat i tendencës për rritjen e varfërisë në rrethinat rurale, duhet të implementohen aktivitete edukative/preventive në rrethinat rurale dhe urbane, që kërkon përgatitje të projekteve paralele për edukim të popullatës lokale për parandalim të tregtisë me njerëz;

-Duke pasur parasysh fuqinë ndikuese të mediave, me rëndësi të veçantë është që të vazhdohet puna me përfaqësuesit e mediave dhe të njëjtat duhet të edukohen për çështje lidhur me tregtinë me njerëz, veçanërisht për nevojën e mbrojtjes së identitetit të viktimave të tregtisë dhe për mundësinë për stigmatizim;

-Duke pasur parasysh se puna me viktimë të tregtisë mund të ndikojë në profesionistët, është e domosdoshme të paraqiten udhëzime, përkrahje dhe mbrojtje, si dhe këmbim të përvojave profesionale;

-Donacionet të cilat u bënë nga OSBE, ndërsa si vijim i saj edhe nga UNICEF, për sigurimin e hapësirës përkatëse të punës dhe përgatitjes teknike për punë me viktimë të hershme janë të rëndësishme së veçantë. Sidoqoftë, është shumë me rëndësi të sigurohen hapësira puhe edhe në QPS të tjera, dhe me këtë të sigurohet trajtim përkatës;

-Edhe pse projekti ka sjellë kategorinë "viktimë të tregtisë me njerë" në formularët e ministrisë, ekziston nevoja plotësuese për institucionalizimin e konceptit dhe për sjelljen e kategorisë së njëjtë edhe në Ligjin për mbrojtje sociale, si dhe për vërtetimin e formave përkatëse të mbrojtjes (lloje trajtimesh dhe e drejta e ndihmës sociale).

Zyra e Mekanizmit Kombëtar për Udhëzime (MKU)



A large, light gray, stylized logo of the Albanian flag is centered in the background. It features a circular base with a smaller circle inside, and several curved, flame-like or wing-like shapes extending from the top right.

Memorandumi për bashkëpunim

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM**Ndërmjet****Ministritë së Punës dhe Politikës Sociale****dhe****OJQ-së Porta e hapur**Lidhur më 14.06.2006 në Shkup**Neni 1***Palët e kontraktuara*

1. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
2. OJQ Porta e hapur/ La Strada Maqedoni

Neni 2*Qëllimet e memorandumit*

Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi i ndërsjellë dhe informimi i ndërsjellë në kuadër të projektit për Mekanizmin nacional të udhëzimit (MNU) bartës i të cilit është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me qëllim të zhvillimit të procedurës standarde operative për udhëzim të viktimave të tregëtisë me njerëz deri në shërbimet speciale, në mënyrë që do të sigurojë mbrojtje dhe avancim të të drejtave të të gjithë njerëzve të cilët janë lëndë të tregëtisë me njerëz, pa dallim të kombi, përkatësie etnike, moshës dhe gjinisë së tyre.

Të dyja palët në këtë Memorandum e pranojnë nevojën për sigurimin e pranimi të gjithëpërfshirës dhe mbrojtjes së viktimave në pajtim me nevojat dhe interesat e tyre.

Shërbimet e këtyre gjithëpërfshirëse me së miri mund të sigurohen përmes zhvillimit të sistemit efektiv për kontakte të përbashkëta, udhëzime dhe bashkëpunim ndërmjet palëve.

Neni 3

Procedura e udhëzimit të viktimave të tregëtisë me njerëz deri në shërbimet e specializuara mund të bëhet vetëm në bazë vullnetare, përkatësisht pas pëlqimit paraprak të personit-viktimë të tregëtisë me njerëz.

Neni 4*Mënyra e bashkëpunimit*

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Porta e hapur janë dakorduar që bashkëpunimi i tyre i përbashkët të zbatohet në mënyrën vijuese:

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE /MNU

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të gjithë personave për të cilët supozohet se janë viktimë të tregëtisë me njerëz (eksplotim seksual, punë të dhunshme, lëmshë e dhunshme, robëri etj.) do t'u ofrojë ndihmë dhe mbrojtje, dhe të njëjtët do t'i udhëzojë dhe vendosë në strehimore ose vend tjetër të sigurtë.

Do të bëjë vlerësimin e nevojave inicuese të viktimave të tregëtisë me njerëz, dhe do të realizojë koordinim të mbrojtjes dhe ndihmës së arritshme.

Do t'i informojë viktimat e tregëtisë me njerëz për të drejtat dhe statusin e tyre, dhe do ta ndjek procesin e risocializimit.

Do të sigurojë ndihmë juridike për viktimat e vendosura dhe do të bashkëpunojë me strukturat përkatëse në sigurimin e mbrojtjes së viktimave dhe mbrojtjes në situata të rrezikshme për jetë;

Do të zbatojë analiza dhe vlerësime të shkaqeve për tregëtinë me njerëz, bazuar në të dhënat, faktet dhe informacionet e mbledhura gjatë intervistimeve të viktimave.

OJQ PORTA E HAPUR / LA STRADA MAQEDONI

Do t'i vendos viktimat e tregëtisë me njerëz në qendrën për pranim të cilët janë drejtuar nga ana e MPPS, Qendrat për punë sociale përmes MNU në bazë të pëlqimit të tyre dhe vullnetit të lirë;

Do të sigurojë ushqim, veshje dhe kushte tjera të domosdoshme për jetën e viktimave të vendosura;

Do të sigurojë përkrahje psikologjike dhe kushte tjera të domosdoshme për jetën e viktimave të vendosura;

Do të sigurojë rehabilitim social dhe riintegrim për viktimat e vendosura, përmes trajnimit arsimor dhe profesional, vetëpunësimit, punësimit, nëse rrethanat e lejojnë një gjë të tillë;

Do ta informojnë MPPS për të gjitha problemet të cilat i përkasin gjendjes së mirë të viktimave të vendosura të cilët janë dërguar nga ana e MPPS;

Do të sigurojnë transport të viktimave në rast nevojë (procedura gjyqësore, vizita familjare). Kthimi i viktimës në familje do të bëhet në pajtim me dëshirën e viktimës dhe familjes;

Do të ndërmjetësojë në realizimin e kontaktit të viktimave me familjet e tyre, do ta lehtësojë rifunksionimin e tyre;

Do të zbatojë analiza dhe vlerësime të shkaqeve për tregëtinë me njerëz, bazuar në të dhënat, faktet dhe informacionet e mbledhura gjatë intervistimit të viktimave të cilat janë vendosur në qendrën për strehim.

Do ta respektojë privatësinë dhe besueshmërinë e informacioneve dhënë nga ato të cilëve ju ndihmohet;

Neni 5

Me qëllim të sigurimit të implementimit të suksesshëm, mbikqyrjes dhe koordinimit të këtij Memorandumi, palët pajtohen të vënë takime të rregullta konsultuese.

Neni 6

Ky Memorandum do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të tij nga palët e lartpërmendura.

Neni 7

Ndryshimet eventuale ose plotësimet e këtij Memorandumi do të bëhen me pëlqim të të dyja palëve.



Foto Galeri

FOTO GALERI



FOTO GALERI



V E R E J T J E . . .



V E R E J T J E . . .



